



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 137

20 gusht

2013

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Dekret nr. 8291 datë 13.8.2013	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 5959
Dekret nr. 8292 datë 14.8.2013	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 5959
Vendim i KM nr. 635, datë 24.7.2013	Për miratimin e memorandumit të mirëkuptimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian, për anëtarësimin e Shqipërisë në programin e të nxëniet gjatë gjithë jetës (Lifelong learning), 2007-2013..... 5960
Vendim i KM nr. 640, datë 24.7.2013	Për miratimin e raportit vjetor “Për ndihmat shtetërore të vitit 2012”..... 5964
Vendim i KM nr. 652, datë 7.8.2013	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2013, miratuar për Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit, në programin “Transporti rrugor”..... 5980
Vendim i KM nr. 653, datë 7.8.2013	Për autorizimin e shoqërisë “V.A.L.E. Recycling” sh.p.k., për importin e mbetjeve për qëllime riciklimi..... 5981
Vendim i KM nr. 671, datë 7.8.2013	Për disa shtesa në vendimin nr. 180, datë 13.2.2013 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e listës së makinerive e të pajisjeve që janë drejtpërdrejt të lidhura me investimin dhe të procedurave të përjashtimeve e të kriterëve përkatëse”..... 5982
Urdhër i MPPT nr. 109, datë 5.8.2013	Për miratimin e rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teorike-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit”..... 5984

DEKRET
Nr. 8291, datë 13.8.2013

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 15, 16 e 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

- | | |
|---|---------------------------------------|
| 1. Julinda Lavdosh Muhametaj | 13. Arnisa Olsi Kotte |
| 2. Gëzim Nikoll Volaj | 14. Arben Hasim Duzha |
| 3. Mira Miqan Zllatiçanin (Kerstoja) | 15. Adhurim Myrtezan Shametaj |
| 4. Mirela Arso Zllatiçanin (Kerstoja) | 16. Aeta Adhurim Shametaj |
| 5. Voin (Vojin) Tosho Matanoviq (Dimnaku) | 17. Lindita Faslli Qevani (Baho) |
| 6. Franko Puka | 18. Erkan Durim Qevani |
| 7. Fatmir Enver Shehu | 19. Angjelina Njac Schwenk (Haxhija) |
| 8. Altin Zyhdi Bajri | 20. Kujtim Muharrem Zhegu |
| 9. Gent Skënder Barbullushi | 21. Dorian Roland Xhoxhi |
| 10. Albert Muharrem Hidri | 22. Ivan Janko Zllatiçanin (Kerstoja) |
| 11. Artur Hysen Metalia | 23. Fatos Sefer Demaj |
| 12. Eni Pellumb Kumbaro | 24. Brunilda Llazar Fani |

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

DEKRET
Nr. 8292, datë 14.8.2013

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9 pika 7 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar në propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Shkelzen Taib Gashi
2. Fatbardha Xhevat Januzi (Basholli)
3. Mirlinda Xhevat Curri (Gashi)



Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

VENDIM
Nr. 635, datë 24.7.2013

**PËR MIRATIMIN E MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT, NDËRMJET REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË DHE BASHKIMIT EUROPIAN, PËR ANËTARËSIMIN E SHQIPËRISË
NË PROGRAMIN E TË NXËNIT GJATË GJITHË JETËS (LIFELONG LEARNING),
2007-2013**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e memorandumit të mirëkuptimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian, për anëtarësimin e Shqipërisë në programin e të nxënit gjatë gjithë jetës (Lifelong Learning), 2007-2013, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI
NDËRMJET BASHKIMIT EUROPIAN DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË MBI
PJESËMARRJEN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË PROGRAMIN E VEPRIMIT NË
FUSHËN E NXËNIES GJATË GJITHË JETËS (2007-2013)

Komisioni Europian, më poshtë quhet “Komisioni”, në emër të Bashkimit Europian, nga njëra anë, dhe Republika e Shqipërisë, më poshtë quhet “Shqipëria”, nga ana tjetër,

ndërsa,

1. Marrëveshja kuadër e datës 22 nëntor 2004 ndërmjet Komunitetit Europian dhe Republikës së Shqipërisë¹ vendos parimet e përgjithshme për pjesëmarrjen e Shqipërisë në programet e Bashkimit, duke i lënë Komisionit dhe autoriteteve kompetente të Shqipërisë të përcaktojnë termat dhe kushtet specifike, duke përfshirë kontributin financiar, në lidhje me këtë pjesëmarrje në çdo program të veçantë.

2. Programi i veprimit në fushën e të nxënit gjatë gjithë jetës u vendos me vendimin nr. 1720/2006/EC² të Parlamentit Europian dhe të Këshillit të datës 15 nëntor 2006.

3. Pjesëmarrja në veprimet e renditura në pikën A.1 të aneksit të vendimit nr. 1720/2006/EC, i nënshtrohet përmbushjes së kritereve, të përmendur në nenin 6.2 në lidhje me kapacitetin menaxherial të agjencive kombëtare dhe mbikëqyrjes nga autoritetet e brendshme, kanë rënë dakord si më poshtë:

¹ GZ L 192, 22.7.2005, f. 2.

² GZ L 327, 24.11.2006, f. 45.

Neni 1

Shqipëria do të marrë pjesë në programin e veprimit në fushën e nxënies gjatë gjithë jetës (më poshtë quhet “Programi i nxënies gjatë gjithë jetës”), në pajtim me kushtet e caktuara në marrëveshjen kuadër të datës 22 nëntor 2004 ndërmjet Komunitetit Europian dhe Republikës së Shqipërisë mbi parimet e përgjithshme për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programet e Komunitetit, dhe sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në anekset I, II dhe III të këtij memorandum mirëkuptimi.

Neni 2

Ky memorandum mirëkuptimi zbatohet gjatë kohëzgjatjes së programit të të nxënies gjatë gjithë jetës. Megjithatë, nëse Bashkimi Europian vendos të zgjasë kohëzgjatjen e programit pa asnjë ndryshim thelbësor brenda programit, ky memorandum do të zgjatej përkatësisht dhe automatikisht nëse asnjë palë nuk e denoncon atë brenda një muaji pas vendimit për zgjatjen.

Anekset I, II dhe III përbëjnë një pjesë integrale të këtij memorandum mirëkuptimi.

Ky memorandum mirëkuptimi mund të ndryshohet vetëm me shkrim me pëlqimin e përbashkët të palëve.

Ky memorandum mirëkuptimi hyn në fuqi në datën e njoftimit me shkrim nëpërmjet të cilit Shqipëria njofton Komisionin nëpërmjet kanaleve diplomatike, që kërkesat e tyre të brendshme ligjore për hyrjen e saj në fuqi janë përmbushur. Në pritje të hyrjes së tij në fuqi, ky memorandum mirëkuptimi zbatohet provizorisht, duke filluar nga viti buxhetor 2013.

Në rast se Shqipëria njofton Komisionin që ajo nuk do të ratifikojë memorandumin e mirëkuptimit të nënshkruar, zbatimi provizor përfundon që nga viti buxhetor pas njoftimit. Njoftimi që përfundon zbatimin provizor nuk ndikon mbi detyrimet e Palëve në lidhje me projektet dhe aktivitetet e financuara nga buxheti i përgjithshëm i Bashkimit Europian i vitit të njoftimit, dhe as pagesën nga Shqipëria të kontributit të saj për vitin e njoftimit.

Bërë në Bruksel
më
Për Republikën e Shqipërisë

Bërë në Bruksel
më
Për Komisionin
në emër të Bashkimit Europian

ANEKSI I

TERMAT DHE KUSHTET PËR PJESËMARRJEN E SHQIPËRISË NË PROGRAMIN E TË NXËNIT GJATË GJITHË JETËS

1. Shqipëria do të marrë pjesë në të gjitha masat e programit të renditura në pikën A.2 të aneksit të vendimit nr. 1720/2006/EC të datës 15 nëntor 2006 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit që vendos programin e të nxënies gjatë gjithë jetës, përveç binjakëzimit elektronik.

2. Përveç kur është parashikuar ndryshe në këtë memorandum mirëkuptimi, Shqipëria do të marrë pjesë në pajtim me objektivat, kriteret, procedurat dhe afatet sipas përcaktimit në vendimin nr. 1720/2006/EC të datës 15 nëntor 2006 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit që vendos programin e të nxënies gjatë gjithë jetës.

3. Për pjesëmarrjen në këtë program, Shqipëria do të paguajë çdo vit një kontribut në buxhetin e përgjithshëm të Bashkimit Europian sipas modaliteteve që përshkruhen në aneksin II.

Nëse është e nevojshme, për të marrë parasysh zhvillimet e programit ose evoluimin e kapacitetit përthithës të Shqipërisë, ky kontribut mund të përshtatet me shkrim me pëlqimin e palëve, për të mënjeluar disbalancën buxhetore në zbatimin e programit.

1. Termat dhe kushtet për paraqitjen, vlerësimin dhe përzgjedhjen e aplikimeve në lidhje me



institucionet, organizatat dhe individët e përshtatshëm të Shqipërisë do të jenë të njëjta si ato që zbatohen për institucionet, organizatat dhe individët e përshtatshëm të Bashkimit European.

2. Me qëllim sigurimin e dimensionit të Bashkimit European për programin, për të qenë të përshtatshme për mbështetjen financiare të Bashkimit European, projektet dhe aktivitetet duhet të përfshijnë të paktën një partner nga shtetet anëtare të Bashkimit European.

3. Shtetet anëtare të Bashkimit European dhe Shqipëria do të bëjnë çdo përpjekje, brenda kuadrit të dispozitave ekzistuese, të lehtësojnë lëvizjen e lirë dhe vendqëndrimin e studentëve, mësuesve, pjesëmarrësve, trajnerëve, administratorëve universitarë, të rinjve dhe personave të tjerë të përshtatshëm që lëvizin ndërmjet Shqipërisë dhe shteteve anëtare të Bashkimit European për qëllimin e pjesëmarrjes në aktivitetet e mbuluara nga ky memorandum mirëkuptimi.

4. Pa cenuar përgjegjësitë e Komisionit dhe Gjykatës së Auditëve të Bashkimit European në lidhje me monitorimin dhe vlerësimin e programit, pjesëmarrja e Shqipërisë në program do të monitorohet vazhdimisht mbi bazë partneriteti, duke përfshirë Komisionin dhe Shqipërinë. Shqipëria do t'i paraqesë Komisionit raportet përkatëse dhe do të marrë pjesë në aktivitete të tjera specifike të ofruara nga Bashkimi European në këtë kontekst.

5. Gjuha që do të përdoret në të gjitha kontaktet me Komisionin, në lidhje me procesin e aplikimit, kontratat, raportet që do të paraqiten dhe masat e tjera administrative të programit do të jenë në një gjuhë zyrtare të Bashkimit European.

6. Bashkimi European dhe Shqipëria mund të ndërpresin aktivitetet sipas këtij memorandum mirëkuptimi në çdo kohë me njoftim me shkrim me afat dymbëdhjetë muaj. Projektet dhe aktivitetet në vazhdim e sipër në momentin e ndërprerjes do të vazhdojnë deri në përfundimin e tyre sipas kushteve të përcaktuara në këtë memorandum mirëkuptimi, si dhe masave kontraktuale që zbatohen për këto projekte dhe aktivitete dhe dispozitat e aneksit III.

Rregullat në lidhje me kontrollin financiar, rikuperimin dhe masat e tjera kundër mashtrimit parashikohen në aneksin III.

ANEKSI II

KONTRIBUTI FINANCIAR I SHQIPËRISË PËR PROGRAMIN E TË NXËNIT GJATË GJITHË JETËS

1. Kontributi vjetor financiar që duhet të paguhet nga Shqipëria në buxhetin e Bashkimit European për të marrë pjesë në programin e të nxënit gjatë gjithë jetës do të jetë 110 000 euro.

2. Shqipëria mund të financojë kontributin e sipërpërmendur pjesërisht nga Buxheti i Shtetit të Shqipërisë dhe pjesërisht nga fondet e paraaderimit të Shqipërisë, në pajtim me procedurat programuese vjetore brenda kuadrit të rregullores së Këshillit (EC) 1085/2006 të datës 17 korrik 2006³. Fondet e kërkuara të paraaderimit do t'i transferohen Shqipërisë çdo vit sipas një Marrëveshjeje Financiare, si një rimbursim i një pjese të kontributit financiar vjetor që paguhen faktikisht në përgjigje të kërkesave për fonde nga Komisioni.

3. Rregullimi financiar i zbatueshëm për buxhetin e përgjithshëm të Bashkimit European do të zbatohet veçanërisht për menaxhimin e kontributit të Shqipërisë.

Shpenzimet e udhëtimit dhe qëndrimit të bëra nga përfaqësuesit dhe ekspertët e Shqipërisë për qëllimet e marrjes pjesë si vëzhgues në punën e komitetit të përmendur në nenin 10 të vendimit të Parlamentit European dhe Këshillit që vendos programin e veprimtimit në sferën e të nxënit gjatë gjithë jetës ose marrjen pjesë në takimet e tjera në lidhje me zbatimin e programit, rimbursohen nga Komisioni mbi të njëjtën bazë dhe në pajtim me procedurat që janë tashmë në fuqi për përfaqësuesit dhe ekspertët e shteteve anëtare të Bashkimit European.

4. Në fillim të çdo viti, Komisioni i dërgon Shqipërisë një kërkesë për fonde që i përket kontributit të saj për programin sipas këtij memorandum mirëkuptimi.

³ GZ L 210, 31.7.2006, f.82

Ky kontribut do të shprehet në euro dhe do të paguhet në një llogari bankare në euro të Komisionit.

Shqipëria do të paguajë kontributin e saj deri në datën 1 prill, me kusht që kërkesa për fonde të dërgohet nga Komisioni para datës 1 mars ose jo më vonë se një muaj pas kërkesës për fonde nëse dërgohet më vonë.

Çdo vonesë në pagesën e kontributit shkakton pagesën e interesit nga Shqipëria për shumën e prapambetur nga data e kërkueshme. Norma e interesit përputhet me normën e zbatuar nga Banka Qendrore Europiane për operacionet e rifinancimit të principalit, të publikuar në serinë C të Gazetës Zyrtare të Bashkimit Europian që është në fuqi në ditën e parë kalendarike të muajit në të cilën bie data e kërkueshme, e rritur me 3.5 pikë përqindje.

ANEKSI III

KONTROLI FINANCIAR, RIKUPERIMI DHE MASA TË TJERA KUNDËR MASHTRIMIT

I. Kontrollet dhe masat kundër mashtrimit nga Bashkimi Europian

1. Në pajtim me rregulloren financiare të zbatueshme për buxhetin e përgjithshëm të Bashkimit Europian dhe me rregullat e tjera të përmendura në këtë memorandum mirëkuptimi, kontratat e lidhura me përfituesit e programeve të vendosur në Shqipëri do të parashikojnë për auditime financiare ose të tjera që duhet të kryhen në çdo kohë në mjediset e përfituesit dhe të nënkontraktorëve të tyre nga agjentët e Komisionit ose nga persona të tjerë të mandatuar nga Komisioni.

2. Agjentët e Komisionit dhe personat e tjerë të mandatuar nga Komisioni mund të hyjnë rregullisht në vendet, punët dhe dokumentet dhe tek i gjithë informacioni i kërkuar për të kryer këto audite, duke përfshirë formatin elektronik. E drejta e aksesit parashikohet shprehimisht në kontratat e lidhura për zbatimin e instrumenteve të përmendura në këtë memorandum. Gjykata Europiane e Auditëve ka të njëjtat të drejta si Komisioni.

3. Brenda kuadrit të këtij memorandum, Komisioni/OLAF-i (Zyra Europiane kundër Mashtrimit) autorizohet të kryejë verifikime dhe inspektime në vend në territorin e Shqipërisë, në pajtim me dispozitat procedurale të rregullores së Këshillit (Euratom, EC) nr. 2185/96 të datës 11 nëntor 1996⁴.

Këto verifikime dhe inspektime përgatiten dhe kryhen në bashkëpunim të ngushtë me autoritetet kompetente të caktuara nga Shqipëria, të cilat njoftohen në kohën e duhur për objektin, qëllimin dhe bazën ligjore të verifikimeve dhe inspektimeve, kështu që ato mund të japin të gjithë ndihmën e kërkuar.

Nëse autoritetet përkatëse të Shqipërisë dëshirojnë, verifikimet dhe inspektimet në vend mund të kryhen bashkërisht me to.

Nëse pjesëmarrësit në programe kundërshtojnë verifikimin dhe inspektimin në vend, autoritetet e Shqipërisë, duke vepruar në pajtim me rregullat e brendshme, u japin inspektorëve të Komisionit/OLAF-it asistencën që atyre u duhet për t'u mundësuar atyre përmbushjen e detyrës në kryerjen e verifikimit ose inspektimit në vend.

Komisioni/OLAF-i u raporton sa më shpejt të jetë e mundur autoriteteve të Shqipërisë për çdo fakt ose dyshim në lidhje me një parregullsi, e cila ka ardhur në vëmendjen e tij gjatë kryerjes së verifikimit ose inspektimit në vend. Në çdo rast, Komisioni/OLAF-it i kërkohet të informojë autoritetin e sipërpërmendur në lidhje me rezultatin e këtyre verifikimeve dhe inspektimeve.

II. Informacioni dhe konsultimi

1. Për qëllimet e zbatimit të rregullt të këtij aneksi, autoritetet kompetente të Shqipërisë dhe

⁴ GZ L 292, 15.11.1996, f. 2



autoritetet e Bashkimit European shkëmbejnë rregullisht informacion dhe, me kërkesën e një prej Palëve, zhvillon konsultime.

2. Autoritetet kompetente të Shqipërisë informojnë Komisionin pa vonesë në lidhje me çdo fakt ose dyshim, i cili ka ardhur në vëmendje të tyre në lidhje me një parregullsi në lidhje me përfundimin dhe zbatimin e kontratave të lidhura në zbatim të instrumenteve të përmendura në këtë memorandum.

III. Masat dhe sanksionet administrative

Pa cenuar zbatimin e ligjit penal të Shqipërisë, masat dhe sanksionet administrative mund të vendosen nga Komisioni në pajtim me rregulloren financiare të zbatueshme për buxhetin e përgjithshëm të Bashkimit European.

IV. Rikuperimi

Vendimet e marra nga Komisioni brenda objektit të këtij memorandum, të cilat vendosin një detyrim financiar për personat e ndryshëm nga shtetet janë të ekzekutueshme në Shqipëri. Ekzekutimi rregullohet nga rregullat e procedurës civile në fuqi në Shqipëri. Urdhri për ekzekutimin e tij i bashkëngjitet vendimit, pa formalitet tjetër përveç verifikimit të vërtetësisë së vendimit nga autoriteti i brendshëm që do të caktojë qeveria e Shqipërisë për këtë qëllim dhe i bëhet i ditur Komisionit. Pas përmbushjes së këtyre formaliteteve me kërkesë të Komisionit, ky i fundit vazhdon me ekzekutimin në pajtim me ligjin e brendshëm, duke ia paraqitur çështjen drejtpërdrejt autoritetit kompetent. Ligjshmëria e vendimit të Komisionit i nënshtrohet kontrollit të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit European.

Vendimet e dhëna nga Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit European në pajtim me një dispozitë arbitrazhi në një kontratë brenda objektit të këtij memorandum janë të ekzekutueshme me të njëjtët terma.

V. Komunikimi i drejtpërdrejtë

Komisioni komunikon drejtpërdrejt me pjesëmarrësit në program të vendosur në Shqipëri dhe me nënkontraktorët e tyre. Ata mund t'i paraqesin Komisionit drejtpërdrejt të gjithë informacionin dhe dokumentacionin përkatës që atyre u kërkohet të paraqesin mbi bazën e instrumenteve të përmendura në këtë memorandum dhe të kontratave të përfunduara për zbatimin e tyre.

VENDIM

Nr. 640, datë 24.7.2013

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT VJETOR “PËR NDIHMAT SHTETËRORE TË VITIT 2012”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 shkronja “dh”, e 18 shkronja “e” të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e raportit vjetor “Për ndihmat shtetërore të vitit 2012”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

RAPORTI PËR NDIHMAT SHTETËRORE 2012

KAPITULLI 1

1. Hyrje

Detyrimet ndërkombëtare për ndihmën shtetërore në Shqipëri, përfshirë kërkesat për transparencë dhe raportimin ndërkombëtar, burojnë nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit me Bashkimin Europian dhe shtetet anëtare, nga marrëveshja e tregtisë së lirë të Europës Qendrore (CEFTA) 2006, si dhe nga marrëveshja për subvencionet dhe masat kundërbalancuese (SCMA) në kuadër të OBT-së. Legjislacioni i ndihmës shtetërore (ligji dhe rregulloret në zbatim të tij) hyri në fuqi në janar 2006⁵, periudhë prej së cilës vepron dhe sistemi kombëtar i ndihmës shtetërore për mbikëqyrjen, kontrollin dhe monitorimin e ndihmës shtetërore.

Në bazë të nenit 17 (dh) të ligjit “Për ndihmën shtetërore”, Komisioni i Ndhmës Shtetërore ka detyrimin të hartojë raportin vjetor për ndihmat shtetërore dhe ta paraqesë atë pranë Këshillit të Ministrave, i cili, pasi e miraton, e përcjell në Komisionin Europian. Raporti për ndihmat shtetërore në Republikën e Shqipërisë, për vitin 2012 është përgatitur në përputhje me këto dispozita ligjore dhe kërkesat e MSA-së dhe CEFTA-s.

Raporti vjetor mbi ndihmën shtetërore të dhënë në Republikën e Shqipërisë për vitin 2012 është raporti i gjashtë vjetor, i cili përmban të dhëna mbi ndihmën shtetërore të dhënë në bazë të akteve normative për të cilat është marrë vendimi i Komisionit të Ndhmës Shtetërore (KNSH) në përputhje me legjislacionin për ndihmën shtetërore.

Në këtë raport janë reflektuar të dhëna dhe informacione të detajuara të ndihmës shtetërore lidhur me dhënësit, përfituesit dhe vlerën totale, me përjashtim të sektorit, i cili është jashtë fushës së zbatimit të ligjit të ndihmës shtetërore.

Në këtë raport paraqiten të dhëna dhe informacione të detajuara të ndihmës shtetërore lidhur me dhënësit, përfituesit, si dhe vlerat për secilën kategori të ndihmës, me përjashtim të sektorëve të bujqësisë dhe peshkimit, të cilët janë jashtë fushës së zbatimit të ligjit të ndihmës shtetërore (në bazë të nenit 2 të ligjit për ndihmën shtetërore), lidhur me sektorin e bujqësisë në këtë raport paraqiten të dhënat vetëm në vlerën totale të ndihmës.

Vlera e ndihmës shtetërore të dhënë në Shqipëri gjatë viteve 2007-2012 është 83.523,75 milionë lekë (≈631 milionë €). Ndhma shtetërore për vitin 2012, duke përfshirë të gjithë sektorët, arrin në vlerën 21.480,77 milionë lekë (154,49 milionë €), që përfaqësojnë 1,6 për qind të PBB-së të Republikës së Shqipërisë.

Në këtë raport janë pasqyruar edhe të dhënat për ndihmën shtetërore për vitet 2008, 2009, 2010 dhe 2011, në mënyrë që të vërehet ecuria e kategorive të ndryshme të ndihmës së dhënë. Mbi bazën e raportimeve nga dhënësit e ndihmës, në këtë raport vërehet se ndryshimet më të rëndësishme i ka pësuar ndihma për kërkim-zhvillim dhe energji.

Përmirësimi i instrumenteve për rritjen e forcimit të advokacisë dhe të kulturës së ndihmës shtetërore është mundësuar edhe nga përdorimi me efikasitet të eksperiencës së marrë nëpërmjet projekteve të binjakëzimit dhe i asistencës teknike të financuar nga programi IPA-2008.

1.2 Metodologjia e raportimit të ndihmës shtetërore

Në hartimin e raportit të gjashtë vjetor për ndihmat shtetërore, struktura e raportimit të ndihmës shtetërore është bazuar në aneksin III të rregullores “Për procedurat dhe formën e njoftimit”⁶, si dhe në metodologjinë e Komisionit Europian⁷.

⁵ Ligji nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar

⁶ VKM nr. 817, datë 28.12.2005 “Për miratimin e rregullores për procedurat dhe formën e njoftimit” Fletore Zyrtare nr. 102, faqe 3235

⁷ http://ec.europa.eu/comm/competition/state_aid/scoreboard/2006/autumn_en.pdf



Në këtë raport, në mënyrë të ngjashme me atë të përdorur në të gjitha raportet e mëparshme, janë paraqitur të dhënat për kategoritë e mëposhtme të ndihmës shtetërore: ndihma horizontale, ndihma sektoriale (vertikale) dhe ndihma shtetërore për sektorin e bujqësisë.

Ndihma horizontale përfshin kategoritë që, kryesisht, synojnë të nxitin zhvillimin rajonal, kërkimin dhe zhvillimin, mbrojtjen e mjedisit dhe kursimin e energjisë, zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, punësimin, trajnimin dhe kulturën.

Ndihma sektoriale i referohet ndihmës shtetërore që jepet për sektorë të veçantë, duke përfshirë sektorin e transportit, shërbimet publike, transmetimet televizive, minierat dhe turizmin.

Ndihma shtetërore për bujqësinë dhe peshkimin nuk bie në fushën e zbatimit të ligjit të ndihmës shtetërore, gjë që është përcaktuar edhe në MSA⁸. Për periudhën tranzitore ajo raportohet apo shpjegohet nga strukturat përkatëse në Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Instrumentet kryesore të përdorura për dhënien e ndihmës shtetërore, siç rezulton në këtë raport (sipas klasifikimit të instrumenteve të ndihmës shtetërore në BE) janë:

- A1 - Subvencione dhe grante;
- A2 - Përrjashtimi nga taksat, shtyrja e taksave, ulja e normës së taksave dhe zbritje e kontributit në sigurimet sociale;
- B - Pjesëmarrja në kapital;
- C1 - Hua të buta;
- C2 - Të tjera instrumente;
- D - Garancitë.

Të dhënat e paraqitura në këtë raport janë raportuar nga dhënësit e ndihmës shtetërore, si: Ministria e Financave (MF), Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE), Ministria e Punëve Publike dhe Transportit (MPPT), Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (MÇSSH), Ministria e Inovacionit dhe Teknologjisë së Informacionit e të Komunikimit (MITIK), Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) dhe Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA).

Gjithashtu, të dhënat e përdorura për krahasim të ndihmës shtetërore me treguesit makroekonomikë të tillë, si: PBB-së, borxhi publik, norma e inflacionit, normat e punësimit në vitet përkatëse etj., janë të dhënat e publikuara nga Ministria e Financave dhe INSTAT-i në *website*-t përkatëse⁹.

KAPITULLI 2

2. Zhvillimet kryesore rregullatore dhe politike në lidhje me ndihmën shtetërore në Shqipëri më 2012-ën

2.1 Situata ekonomike në Shqipëri

Raportimi i ndihmave shtetërore të dhëna për vitin 2012 është mbështetur në një informacion krahasues të ecurisë të treguesve kryesorë makroekonomikë në Shqipëri.

Referuar Ministrisë së Financave MF¹⁰, ekonomia shqiptare ka vijuar të mbetet në terren pozitiv të rritjes ekonomike edhe përgjatë vitit 2012. Norma mesatare vjetore e inflacionit për periudhën janar-tetor të vitit 2012 ishte rreth 2 për qind. Tregu i punës ka mbetur përgjithësisht i qëndrueshëm dhe nuk ka pasur efekte të forta negative të transmetuara në të edhe përgjatë gjysmës

⁸ Neni 71 pika 8 e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit

⁹ www.minfin.gov.al

www.instat.gov.al/

¹⁰ www.minfin.gov.al/minfin/Fjala_e_Zv_Ministrit_te_Financave_Z_Nezir_Haldeda_ne_Konferencen_e_Kryetareve_ne_Kuvend_per_prez_an_2359_1.php

së parë të 2012. Punësimi ka njohur një rritje të lehtë gjatë vitit 2012. Sipas INSTAT-it në vitin 2012 punësimi shënon shifrën prej 964 363 kundrejt 932 388 të punësuarve në vitin 2011.

Mbështetur në të dhënat e publikuara nga INSTAT-i, prodhimi i brendshëm bruto (PBB) u rrit me 1.5 për qind gjatë vitit 2012, i mbështetur nga rritja e aktivitetit në sektorin e shërbimeve dhe në atë të bujqësisë.

Shpenzimet për subvencione janë parashikuar duke u bazuar në politikën ekzistuese të zbatuar nga Ministria e Financave atë të reduktimit të subvencioneve. Në parashikimet vjetore mbahet parasysh ulja progresive e subvencioneve e kombinuar me përmirësimin e menaxhimit më të mirë të sektorëve dhe ndikuar në rritjen e performancës së tyre.

Sipas MF-së në vitin 2012 ekonomia shqiptare vazhdoi të performojë me një rritje pozitive, e cila vlerësohet në rreth 3.1 për qind, norma e papunësisë është ulur në nivelin 12.8 për qind, ndërsa deficitin i llogarisë korente arriti në 10.9 për qind të PBB-së në vitin 2012 nga 12.5 për qind në vitin 2011.

Tabela 1 pasqyron zhvillimet në sektorin fiskal, monetar dhe atë të punës për periudhën 2008-2012.

Tabela 1. Treguesit kryesorë ekonomikë për periudhën 2008-2012

Treguesit makro-ekonomik	2008	2009	2010	2011	2012
Rritja reale e PBB (në %)	7.7	3.3	4.1	3.0	1.5
PBB (me çmimet korrente, në milionë LEK)	1,088,132	1,143,373	1,222,631	1,314,702	1,346,169
PBB (në milion Euro)	8,843.00	8,655.36	8,873.3	9,356.3	9,670.8
Popullsia (në milion banorë)	3.17	3.19	3.19	2.83	2.83
PBB (për frymë në Euro)	2,791	2,728	2,777.6	3,304.1	3,415.1
Numri i të punësuarve (në mijë)	970	972	917	932	964
Përqindja e papunësisë	13.20	13.75	13.3	13.29	12.81
Norma e inflacionit	3.4	3.5	3.6	3.5	2.0
Deficiti Buxhetor (në % ndaj PBB)	-5.50	-7.00	-3.00	-3.5	-3.7
Borxhi publik (në % ndaj PBB)	54.90	59.50	59.4	58.9	61.9
Borxhi i jashtëm (në % ndaj PBB)	18.00	23.10	25.7	22.5	23.5
Llogaria korrente (në % ndaj PBB)	-14.9	-15.6	-10.4	-12.5	-10.9
Kursi mesatar i këmbimit, LEK/EURO	123.80	132.10	137.79	140.33	139.04

2.2 Detyrimet ndërkombëtare në lidhje me ndihmën shtetërore¹¹

Detyrimet e Shqipërisë për një sistem rregullator transparent lidhur me ndihmat shtetërore dhe subvencionet (duke përfshirë edhe raportimet) rrjedhin nga MSA-ja¹², vendimi i Partneritetit Europian i nëntorit 2007¹³, marrëveshja e OBT-së “Për subvencionet dhe masat kundërbalancuese”¹⁴, si dhe marrëveshja e CEFTA-s (2006)¹⁵.

Megjithëse detyrimet ndërkombëtare kanë nxitur Shqipërinë për të përshtatur subvencionimin dhe ndihmat shtetërore me normat dhe praktikat ndërkombëtare, arsyetimi për futjen e këtij sistemi ka një dimension kombëtar që është tejet i rëndësishëm për Shqipërinë dhe thajse i

¹¹ Për detaje të mëtejshme të shihet kapitulli 3 i raportit vjetor të ndihmave shtetërore të vitit 2007

¹² Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit midis Komunitetit Europian dhe shteteve anëtare, nga njëra anë dhe Republikës së Shqipërisë nga ana tjetër, nënshkruar më 12 qershor 2006.

¹³ Vendimi i Këshillit Europian mbi parimet, prioritetet dhe kushtet e Partneritetit Europian me Shqipërinë dhe shfuqizimin e vendimit 2006/54/EC, COM (2007) 656 përfunduar 6 nëntor 2007.

¹⁴ Marrëveshja për Subvencionet dhe Masat Kundërbalancuese, 1994, Sekretariati GATT (1994) rezultatet e raundit të Uruguait për negociatat tregtare shumëpalëshe, teksti ligjor, Gjenevë, “Marrëveshja për subvencionet dhe masat kundërbalancuese”, faqe 264-314.

¹⁵ Marrëveshja e Tregtisë së Lirë e vendeve të Europës Qendrore dhe Lindore (2006) Marrëveshja për Amendimin dhe Zgjerimin e Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Europës Qendrore (CEFTA), <http://www.stabilitypact.org/et2/TradeCEFTA2006.asp>



pavarur nga faktorët e jashtëm. Në mënyrë të veçantë, ndihmat shtetërore dhe subvencionet në Shqipëri po jepen gjithnjë e më shumë në funksion të përdorimit racional të burimeve të limituara buxhetore, për të realizuar në mënyrë eficiente programet e zhvillimit brenda vendit dhe për të shmangur shpërdorimin e fondeve publike.

Më 1 prill 2009 hyri në fuqi Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, ndërkohë që është shfuqizuar marrëveshja e përkohshme (INTERIM), e cila hyri në fuqi më 1 dhjetor 2006. Detyrimet e marrëveshjes së përkohshme, në fushën e veprimit të së cilës hynte edhe ndihma shtetërore, do të jenë tashmë pjesë përbërëse e MSA-së. Rrjedhimisht, MSA përbën bazën ligjore të ndihmës shtetërore tek e cila mund të bëhet referim i drejtpërdrejtë.

Në drejtim të raportimit, MSA kërkon raportim të rregullt reciprok, pra kërkon transparencë ndërkombëtare në lidhje me të gjitha masat e marra nga autoritetet administrative në nivel lokal dhe qendror, si dhe nga institucionet e tjera që veprojnë në emër të shtetit, lidhur me përdorimin e burimeve shtetërore. Ndërsa në BE tashmë funksionon një mekanizëm raportues i detajuar/transparent vjetor për ndihmat shtetërore, në Shqipëri kjo ka filluar në vitin 2007.

Raportet vjetore të ndihmave shtetërore¹⁶ janë në përputhje me këto detyrime. Edhe në sistemin e OBT-së, është standard, përgatitja e raporteve të detajuara për subvencionet industriale, kërkesë të cilën Shqipëria e plotësoi në mars 2008.

Vendimi i Partneritetit European në shkurt 2008¹⁷ thekson, ndër të tjera, rëndësinë e zbatimit të legjislacionit për ndihmën shtetërore dhe përditësimin e vazhdueshëm të inventarit të skemave të ndihmës shtetërore. Në një periudhë afatmesme, vendimi i Partneritetit European kërkon t'i jepet përparësi zhvillimit dhe forcimit të mëtejshëm të kontrollit të ndihmës shtetërore dhe përfundimit të përshtatjes së skemave të ndihmës shtetërore me rregullat e BE-së. Vazhdimi i zbatimit të sistemit rregullator të ndihmës shtetërore dhe zgjerimi i mëtejshëm i saj në vitin 2008 është realizuar në përputhje me këto udhëzime.

2.3 Zhvillimet kryesore për ndihmën shtetërore në vitin 2012

Plotësimi dhe përafrimi i legjislacionit

Në përmbushje të detyrimeve në kuadër të anëtarësimit në Bashkimin European, konkretisht sipas nenit 71 pika 7 paragrafi b të Marrëveshjes së Asociim-Stabilizimit, struktura e ndihmës shtetërore ka përgatitur hartën rajonale për ndihmën shtetërore, në bazë të VKM nr. 1037, datë 15.12.2010 "Për zbatimin e nomenklaturës "Shqipëria në 3 (tri) rajone NUTS II", si dhe të dhënave të paraqitura nga INSTAT-i në botimin "Llogaritë rajonale në Shqipëri", e cila është miratuar nga Komisioni i Ndihmës Shtetërore me vendim nr. 43, datë 11.9.2012. Ky vendim u miratua paraprakisht dhe nga strukturat përkatëse të Komisionit European¹⁸.

Zbatimi i legjislacionit në fushën e ndihmës shtetërore

Një ndër detyrat kryesore gjatë vitit 2012 ka qenë zbatimi i procedurave për shqyrtimin e planeve të reja për dhënien e skemave të ndihmës dhe ndihmave individuale, të njoftuara nga dhënësit e ndihmës në nivel qendror dhe lokal. Edhe këtë periudhë ka vazhduar kontrolli i zbatimit të legjislacionit për ndihmën shtetërore, analiza dhe vlerësimi ekonomik dhe ligjor, si dhe ndjekja e të gjitha procedurave për shqyrtimin e planeve të reja për dhënien e ndihmës shtetërore, sipas të gjitha afateve kohore të përcaktuara në ligjin nr. 9374, datë 21.4.2005 "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar dhe rregulloret përkatëse.

Mbi bazën e raporteve vlerësuese të përgatitura nga Sektori i Ndihmës Shtetërore, Komisioni i Ndihmës Shtetërore, në mbledhjet e zhvilluara gjatë kësaj periudhe ka marrë në shqyrtim një plan të ri për dhënie ndihme dhe një akt normativ, për të cilat ka dhënë vendimet përkatëse:

¹⁶ Miratuar me vendime të Këshillit të Ministrave dhe dërguar në Komisionin European dhe CEFTA.

¹⁷ Vendimi i Këshillit European 2008/210/EC 18 shkurt 2008 mbi parimet, prioritet dhe kushtet e Partneritetit European me Shqipërinë.

¹⁸ Drejtoria e Përgjithshme e Konkurrencës (DG Competition)

1. Vendimin nr. 44, datë 11.9.2012 “Për planin e dhënies së ndihmës shtetërore “Për krijimin e fondit të inovacionit”. Komisioni i Ndhmës Shtetërore vendosi se skema konsiderohet si ndihmë “de minimis”, në bazë të nenit 8 të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, në të cilin përcaktohet se “ndihma *de minimis* është e lejueshme nëse ajo, pavarësisht formës ose qëllimit për të cilin jepet, nuk kalon vlerën prej 100.000 euro, për një periudhë financiare prej tre vjetësh, dhe, në të njëjtën kohë, nuk jepet për veprimtaritë e eksportit, nuk kushtëzohet me përdorimin e produkteve vendase kundrejt produkteve të importuara dhe përfituesi nuk është një ndërmarrje në vështirësi.”

2. Vendimin nr. 42, datë 11.9.2012 “Për shqyrtimin e aktit normativ nr. 4, datë 14.12.2011 “Për një ndryshim në ligjin nr. 10 355, datë 2.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2011”, të ndryshuar”. Komisioni i Ndhmës Shtetërore vendosi se akti normativ nr. 4, datë 14.12.2011 “Për një ndryshim në ligjin nr. 10 355, datë 2.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2011”, të ndryshuar”, nuk përbën ndihmë shtetërore, sipas përcaktimit të nenit 4 të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar.

Të gjitha vendimet e KNSH-së janë të publikuara në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë¹⁹.

Kapacitetet institucionale/administrative

Programi IPA 2008 “Mbështetje për Autoritetin e Konkurrencës dhe Drejtorinë e Ndhmës Shtetërore”, ka ofruar asistencë për strukturën e ndihmës shtetërore për një periudhë 2010-2012, ku përfitues ishin struktura e ndihmës shtetërore, dhe Autoriteti i Konkurrencës, me një kosto totale të projektit prej 1.500.000 euro. Ky projekt kishte si objektiv krijimin e një tregu konkurrues në Shqipëri përmes rregullave të konkurrencës dhe ndihmës shtetërore, si dhe zbatimin e tyre, për nxitjen e konkurrencës e ndërmarrjeve shqiptare sipas rregullave të vendosura nga BE-ja, dhe përpjekjet e përbashkëta me strukturat homologe të rajonit të Ballkanit për siguruar plotësimin e kërkesave të tregut të brendshëm.

Nëpërmjet projektit të binjakëzimit, struktura e ndihmës shtetërore është asistuar nga ekspertët e projektit për forcimin e kapaciteteve institucionale, për diskutimin e rasteve konkrete të ndihmës shtetërore dhe atyre hipotetike. Në kuadër të rritjes së nivelit të ndërgjegjësimit të grupeve të interesit për fushën e ndihmës shtetërore janë zhvilluar disa aktivitete informuese me mbështetjen e projektit IPA, në disa nga qytetet kryesore të vendit, si: Shkodra, Elbasani e Tirana.

KAPITULLI 3

3.1 Ndhma shtetërore për vitin 2012

Vështrim mbi ndihmën shtetërore në Shqipëri në periudhën 2008-2012

Ndhma shtetërore për vitin 2012 në Republikën e Shqipërisë është vlerën 21.480,77 milionë lekë. Kjo vlerë e ndihmës është 30 % më shumë në krahasim me vitin 2011. Treguesi i ndihmës shtetërore kundrejt PBB-së për vitin 2012 është 1.6 për qind, duke pësuar një rritje në krahasim me 2011, ku llogaritej në 1.26 për qind.

Në vitin 2012 ndihma shtetërore për çdo punonjës llogaritet në vlerën 22.283 lekë, e cila këtë vit ka një rritje prej 26 për qind në krahasim me 2011, kur ndihma për çdo punonjës ishte në vlerën 17.752 lekë. Ndhma shtetërore për frymë, gjithashtu, shënon një rritje nga 5.843 lekë për vitin 2011, në 7.590 lekë për vitin 2012, në një rritje prej 30 për qind.

¹⁹ www.qbz.gov.al



Tabela 2. Ndihma shtetërore në Shqipëri për vitet 2008-2012
(përfshirë bujqësinë dhe peshkimin)

Emërtimi	Njësia e matjes	Vitet					Indekset	
		2008	2009	2010	2011	2012	2011/ 2010	2012/ 2011
<i>kursi mesatar i këmbimit</i>		<i>122.80</i>	<i>132.10</i>	<i>137.80</i>	<i>140.33</i>	<i>139.04</i>		
Ndihma shtetërore	million LEK	12,598.76	6,952.16	10,084.24	16,545.28	21,480.77	164%	130%
Ndihma shtetërore	million Euro	102.60	52.63	73.36	117.90	154.49	161%	131%
PBB nominal	million LEK	1,088,132	1,143,373	1,222,631	1,314,702	1,346,169	108%	102%
PBB nominal	million Euro	8,843.00	8,655.36	8,873.3	9,356.3	9,670.8	105%	103%
Ndihma shtetërore në raport ndaj PBB	%	1.16%	0.61%	0.83%	1.26%	1.60%	152%	127%
Shpenzimet gjithsej	million LEK	351,492	379,602	361,500	376,400	376,200	104%	100%
Shpenzimet gjithsej	million Euro	2,862.31	2,873.60	2,623.37	2,682.25	2,705.70	102%	101%
Ndihma shtetërore në raport ndaj shpenzimeve gjithsej	%	3.58%	1.83%	2.79%	4.40%	5.71%	158%	130%
Numri i të punësuarve	million	0.970	0.972	0.917	0.932	0.964	102%	103%
Ndihma shtetërore për çdo punonjës	LEK	12,988	7,152	10,997	17,752	22,283	161%	126%
Ndihma shtetërore për çdo punonjës	Euro	106	54	80	127	160	159%	127%
Numri i të papunëve	million	0.154	0.145	0.143	0.142	0.142	99%	100%
Ndihma shtetërore për çdo të papunë	LEK	81,974	48,025	70,519	116,516	151,534	165%	130%
Ndihma shtetërore për çdo të papunë	Euro	668	364	512	830	1,090	162%	131%
Popullsia	million	3.17	3.19	3.19	2.83	2.83	89%	100%
Ndihma shtetërore për frymë	LEK	3,974	2,179	3,161	5,843	7,590	185%	130%
Ndihma shtetërore për frymë	Euro	32	16	23	42	55	181%	131%

Rritja e vlerës së ndihmës totale për vitin 2012, në krahasim me vitin 2011, në shumën prej 4.935,5 milionë lekë ka ardhur për shkak të një rritje të ndjeshme të ndihmës për kërkim dhe zhvillimin dhe energji. Por më pak ndihmë është dhënë për transportin publik, shërbimet publike dhe punësimin.

Referuar metodologjisë së BE-së, ku ndihma shtetërore për sektorët e bujqësisë, peshkimit dhe transportit monitorohen dhe vlerësohen secila më vete, në tabelën 3, paraqiten të dhënat e ndihmës shtetërore në Shqipëri, për 5 vitet e fundit, duke përjashtuar vlerën e ndihmës së dhënë për sektorët e bujqësisë, peshkimit dhe transportit. Vlera e ndihmës shtetërore në vitin 2012 është 18.876,92 milionë lekë, duke përjashtuar sektorët e bujqësisë, peshkimit dhe transportit.

Pjesa që zë ndihma shtetërore (pa përfshirë sektorët e bujqësisë, peshkimit dhe transportit) në raport me PBB-në përdoret nga BE-ja për të bërë krahasimet midis shteteve, si dhe për të monitoruar prirjen e vlerës totale të ndihmës shtetërore. Nivelet e ndihmës shtetërore ndaj PBB-së nga 1.061 % për vitin 2011 arrin në 1.404 % për vitin 2012.


Tabela 3. Ndihma shtetërore në Shqipëri për vitet 2008-2011
(përfshijtur bujqësinë, peshkimin dhe transportin)

Emërtimi	Njësia e matjes	2008	2009	2010	2011	2012
Ndihma shtetërore totale	million LEK	10,925.00	5,415.92	8,686.35	13,925.71	18,876.92
Ndihma shtetërore	million Euro	88.97	41.00	63.22	99.24	135.77
PPB Nominal	million LEK	1,088,132	1,143,373	1,222,631	1,314,702	1,346,169
PPB Nominal	million Euro	8,843	8,655	8,873	9,356	9,671
Ndihma shtetërore ndaj PPB	%	1.006	0.474	0.712	1.061	1.404

Në grafikun 1 paraqitet ecuria e treguesit të raportit të ndihmës shtetërore ndaj PBB-së për vitet 2008-2012. Në vitin 2009 ndihma shtetërore ndaj PBB-së pësoi një rënie të ndjeshme, saktësisht, nga 1.16 për qind në vitin 2008 në 0.61 për qind.

Nga viti 2010 ky tregues pëson rritje në 0.83 për qind për vitin 2010 në 1.26 për qind në vitin 2011 dhe për vitin 2012 ky tregues arrin në nivelin 1.6 për qind. Në grafik paraqiten, gjithashtu, edhe treguesit e raportit të ndihmës shtetërore ndaj PBB-së për vitet 2008-2012, përfshijtur bujqësinë, peshkimin, ndihmën individuale dhe transportin.

Grafiku 1. Ndihma shtetërore në raport ndaj PBB-së për periudhën 2007 – 2012



Mesatarja e raportit të ndihmës shtetërore ndaj PBB-së për vendet e BE-së (pa bujqësinë, peshkimin dhe transportin), siç paraqitet edhe në tabelën 4, për EU 27 arrin në vlerën prej 0.42 %²⁰. Vlera e ndihmës shtetërore duke përfshijtur sektorët e bujqësisë, peshkimit dhe transportit ndaj PBB-së për vitin 2011 për Shqipërinë është në vlerën prej rreth 1 %.

²⁰ http://ec.europa.eu/competition/state_aid/studies_reports/studies_reports.html



Tabela 4. Ndihma shtetërore në Shqipëri në total e krahasuar me mesataren në BE

Emri i Shteteve	Ndihma shtetërore në billion EURO për vitin 2011		Ndihma shtetërore/PPB në % për vitin 2011	
	Totali i ndihmës shtetërore (me përjashtim të transportit)	Ndihma shtetërore për Sektorin e industrisë dhe shërbimeve (me përjashtim bujqësisë, peshkimit dhe transportit)	Totali i ndihmës shtetërore (me përjashtim të transportit)	Ndihma shtetërore për Sektorin e industrisë dhe shërbimeve (me përjashtim bujqësisë, peshkimit dhe transportit)
Shqipëria	0.10	0.10	1.10	1.06
EU27	64.28	52.96	0.51	0.42
Belgjika	1.59	1.24	0.43	0.34
Bullgaria	0.04	0.02	0.10	0.05
Çekia	1.42	1.17	0.92	0.76
Danimarka	1.09	0.83	0.46	0.35
Gjermania	13.62	12.46	0.53	0.48
Estonia	0.05	0.02	0.32	0.11
Irlanda	1.06	0.67	0.68	0.43
Greqia	2.59	2.17	1.21	1.01
Spanja	4.53	3.71	0.42	0.35
Franca	12.36	10.48	0.62	0.52
Italia	3.81	2.92	0.24	0.18
Qipro	0.14	0.10	0.79	0.54
Letoni	0.18	0.06	0.92	0.29
Lituani	0.21	0.12	0.68	0.40
Luksemburg	0.10	0.08	0.24	0.19
Hungaria	1.12	0.86	1.11	0.86
Malta	0.10	0.09	1.60	1.43
Hollanda	2.67	1.78	0.44	0.30
Austria	1.71	1.51	0.57	0.50
Polonia	2.82	2.13	0.76	0.58
Portugalia	1.77	1.75	1.03	1.02
Rumania	0.55	0.28	0.40	0.21
Sllovenia	0.40	0.33	1.11	0.91
Sllovakia	0.17	0.16	0.25	0.23
Finlanda	2.34	1.06	1.24	0.56
Suedia	3.02	2.79	0.78	0.72
Anglia	4.80	4.18	0.27	0.24
Iceland	50.53	50.53	0.50	0.50
Liechtenstein	1.49	1.49	0.04	0.04
Norway	2,788.42	2,557.99	0.80	0.73

3.2 Kategoritë e ndihmës shtetërore

Në vitin 2012 krahasuar me vitin 2011, përveç rritjes prej 4.935,49 milionë lekë në shumën e ndihmës shtetërore totale, nuk vërehen ndryshime në kategoritë kryesore të ndihmës së dhënë në ekonominë vendase. Më konkretisht, këtë vit, tendencë në rritje kanë pësuar të dyja kategoritë e ndihmave përkatësisht ndihma horizontale në masën 4.822,68 milionë lekë dhe ndihma sektoriale në masën 116,53 milionë lekë në krahasim me vitin 2011.

Në vitin 2012, ndihma shtetërore për sektorin e bujqësisë është dhënë në shumën totale prej 2.163,85 milionë lekë, e cila përbën 10.7% të totalit të ndihmës shtetërore të dhënë. Ndihma shtetërore e dhënë për sektorin e industrisë dhe shërbimeve arriti në 19.316,92 milionë lekë dhe kjo

përbën 89.9% të totalit të ndihmës shtetërore të dhënë. Në totalin e ndihmës për vitin 2012 peshën më të madhe prej 68% e përbën ndihma për kërkim-zhvillim.

Tabela 5. Klasifikimi sipas kategorive të ndihmës shtetërore në Shqipëri


Kategoria e ndihmës		2010			2011			2012		
		mln LEK	mln EUR	(%)	mln LEK	mln EUR	(%)	mln LEK	mln EUR	(%)
kursi mesatar i këmbimit		137.80			140.33			139.04		
1	Bujqësia	913.89	6.63	9.0	2,167.58	15.4	13.1	2,163.85	15.6	10.07
2	Industri dhe Shërbime	9,170.35	66.73	91.25	14,377.71	102.46	86.90	19,316.92	138.93	89.93
A	Ndihmat horizontale	7,892.46	57.46	78.3	11,982.85	85.39	72.4	16,805.5	120.87	78.24
	1 Punësimi	53.69	0.39	0.5	37.25	0.27	0.2	23.30	0.17	0.11
	2 Kultura	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	3 Mjedisi	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	4 Eksperti	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	5 Ndihma operacionale	3,119.04	22.63	30.9	2,483.52	17.70	15.0	2,205.33	15.86	10.27
	6 Shpëtimi dhe rristurimi	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	7 Kërkimi dhe Zhvillimi dhe inovacion	4,621.00	33.53	45.7	9,399.78	66.98	56.8	14,504.00	104.32	67.52
	8 SME-të	16.20	0.30	0.4	-	-	-	8.10	0.06	0.04
	9 Sporti	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	10 Trainimi	82.53	0.60	0.8	62.30	0.44	0.4	64.80	0.47	0.30
B	Ndihma sektoriale	1,277.89	9.27	12.9	2,394.86	17.07	14.5	2,511.39	18.06	11.69
	11 Transporti publik	484.00	3.51	4.8	452.00	3.22	2.7	440.00	3.16	2.05
	12 Shërbimet publike	785.00	5.70	7.8	773.00	5.51	4.7	787.00	5.66	3.66
	13 Minierat	6.00	0.04	0.1	5.00	0.04	0.03	13.00	0.09	0.06
	14 Energjia	-	-	-	1,161.97	8.28	7.0	1,268.50	9.12	5.91
	15 Televizionet/mediat	2.89	0.02	0.3	2.89	0.02	0.02	2.89	0.02	0.01
	16 Turizmi	-	-	-	-	-	-	-	-	-
C	Ndihma Rajonale	-	-	-	-	-	-	-	-	-
TOTALI		10,084.24	73.36	100	16,545.28	117.90	100	21,480.77	154.49	100

Ndihma horizontale përbën 78.24 % të të totalit të ndihmës shtetërore të dhënë për vitin 2012 me shumë prej 16.805,5 milionë lekë, në vitin 2011 kishte një peshë prej 86% dhe në vitin 2010 kishte një peshë prej 91.25%.

Ndihma sektoriale përbën 11.7 % të totalit të ndihmës shtetërore të dhënë për vitin 2012 me shumë prej 2.511,39 milionë lekë, në vitin 2011 kishte një peshë prej 14.5% dhe në vitin 2010 kishte një peshë prej 13%.

Sic paraqitet në grafikun 2 peshën më të madhe në totalin e ndihmës për të tria vitet e përbën ndihma horizontale.


Grafiku 2. Ndihma shtetërore sipas kategorive në % për vitet 2010-2012





Sikurse vërehet edhe në grafikun 3, pjesën më të madhe në kategorinë horizontale në vitin 2012 e zë ndihma për kërkim dhe zhvillim me 67.52 për qind, duke u pasuar nga ndihma operacionale me 10.27 për qind. Në këtë kategori rënie kanë pësuar ndihma për punësim me 13.95 milionë lekë. Në kategorinë e ndihmave vertikale (sektoriale), rënien shënon ndihma për transportin publik me 12 milionë lekë.

Grafiku 3. Ndhimja shtetërore për vitin 2012 në %



3.3 Instrumentet e ndihmës shtetërore

Duke ndjekur metodologjinë e BE-së për raportimin e ndihmës shtetërore, në këtë raport janë paraqitur të dhënat për kategoritë e ndihmës shtetërore, të tilla si: ndihma horizontale, ndihma sektoriale (vertikale) dhe ndihma “Ad-hoc”.

Instrumentet kryesore të përdorura për dhënien e ndihmës shtetërore, siç rezulton në këto raporte, kanë qenë grantet, përjashtimi dhe ulja e taksave (sipas klasifikimit të instrumenteve të ndihmës shtetërore në BE):

- A1 - Subvencione dhe grante;
- A2 - Përjashtimi nga taksat, shtyrja e taksave, ulja e normës së taksave dhe zbritje e kontributit në sigurimet sociale;
- B - Pjesëmarrja në kapital;
- C1 - Hua të buta;
- C2 - Instrumente të tjera;
- D - Garancitë.

Tabela 6. Ndhimja shtetërore në Shqipëri e klasifikuar sipas instrumenteve

Kategoria e Instrumenteve	Instrumentat e Ndhmës Shtetërore	Treguesit	2008	2009	2010	2011	2012
A1	Subvencione dhe Grante	%	21.20	27.75	15.57	9.25	6.18
		lek	2,473.07	1,645.32	1,427.42	1,329.55	1,194.20
		eur	20.14	12.46	10.54	9.47	8.59
A2	Përrjashtim nga taksat, shtyrja e taksave, ulja e normës së taksave dhe zbritje e kontributit në sigurimet	%	78.77	72.20	84.40	90.73	93.07
		lek	9,186.38	4,281.27	7,740.04	13,045.27	17,977.83
		eur	74.81	32.41	56.17	92.96	129.30
B	Pjesmarrje në kapital	%	-	-	-	-	-
		lek	-	-	-	-	-
		eur	-	-	-	-	-
C1	Hua të buta	%	-	-	-	-	-
		lek	-	-	-	-	-
		eur	-	-	-	-	-
C2	Të tjera instrumente	%	0.02	0.05	0.03	0.02	0.75
		lek	2.89	2.89	2.89	2.89	144.89
		eur	0.02	0.02	0.02	0.02	1.04
D	Garancitë	%	0.00	0.00	-	-	-
		lek	0.42	0.15	-	-	-
		eur	0.00	0.00	-	-	-

Instrumenti që zë peshën më të madhe në vitin 2012 është (A2) (ku përfshihen përjashtimet, shtyrja/ulja e normës së taksave dhe zbritja e kontributit të sigurimeve sociale) me 93 për qind, me një vlerë prej 17.977,83 milionë lekë, ndjekur nga (A1) (ku përfshihen subvencionet dhe grantet) me 6.18 për qind në vlerën prej 1.194,2 milionë lekë, ndërsa instrumenti (C2) me 0.75 për qind në vlerën prej 144,89 milionë lekë.

Në instrumentin e “Përrjashtimi nga taksat dhe shtyrja e taksave” (A2), në vitin 2012 vërehet se peshën e madhe e ka ndihma për kërkim-zhvillim prej 75.08 për qind, e pasuar nga ajo operationale prej 11.42 për qind dhe ndihma për energjinë në 6.57 për qind.

Në ndihmat operationale përfshihen: skema e shtyrjes së pagesës së TVSH-së së makinerive dhe pajisjeve të importuara, si dhe ajo e energjisë elektrike të importuar nga KESH sh.a.²¹, skema për rimbursimin e akcizës së lëndëve djegëse, të konsumuar në serat me ngrohje për prodhimin e produkteve industriale dhe agroindustriale, të cilat përdoren për nevojat teknologjike të prodhimit²² dhe skema për përjashtimin nga akciza të lëndëve djegëse, të përdorura për prodhimin e energjisë elektrike nga termocentralet me fuqi më të madhe se 5MW²³.

Në instrumentin A1, i cili ka një vlerë prej 1.194,2 milionë lekë janë përfshirë subvencionet (për transportin hekurudhor, ndërmarrjet e ujës-jellësve, minierat, SME-të dhe tregun e punës) e dhëna në bazë të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”.

Instrumenti i garancisë shtetërore (D) për vitin 2012 është zero lekë, sipas raportimit të kryer nga dhënësi i ndihmës AIDA, skema do të rishikohet në tërësi. Në këtë instrument përfshihet skema e “Fondit të garantimit të kredive të eksportit”²⁴, vlera e ndihmës së dhënë financon kërkesat për kolateral për kredi tregtare të kërkuar nga bankat, duke rritur shkallën e konkurrueshmërisë së ndërmarrjeve shqiptare. Fondi lëshon garanci për eksportuesit, kur ata kanë nevojë për financime afatshkurtra, për të përfunduar marrëveshjet me blerësit e huaj.

²¹ Vendimi i KNSH nr. 17, datë 16.7.2007 “Për skemën e shtyrjes së pagesës së TVSH-së makinerive dhe pajisjeve të importuara, si dhe të energjisë elektrike të importuar nga KESH sh.a.”

²² Vendimi i KNSH nr. 24, datë 2.5.2008 “Për përcaktimin e kushteve dhe procedurave për rimbursimin e akcizës së lëndëve djegëse, të konsumuar në serat me ngrohje për prodhimin e produkteve industriale dhe agroindustriale, të cilat përdoren për nevojat teknologjike të prodhimit”.

²³ Vendim i KNSH nr. 25, datë 2.5.2008 “Për planin e dhënies së ndihmës shtetërore për përjashtimin nga akciza të lëndëve djegëse, të përdorura për prodhimin e energjisë elektrike nga termocentralet me fuqi më të madhe se 5MW”, i ndryshuar me vendimin nr. 27, datë 18.8.2008 të KNSH.


²⁴ Vendim i KNSH nr. 16, datë 16.7.2007 “Për planin e dhënies së ndihmës shtetërore “Për fondin e garantimit të kredive të eksportit””



Tabela 7. Instrumentet e dhënies së ndihmës shtetërore për vitin 2012

Kategoria e ndihmës	Subvencione dhe Grante	Përfshirje nga taksat, shtyrja e taksave, ulja e normës së taksave dhe zbritje e kontributit në sigurimet sociale	Të tjera instrumente	Total
I Ndihamat horizontale				16,806
1 Punësimi	23.30			23
2 Ndihamat operacionale		2,205.33		2,205
3 Kërkimi dhe Zhvillimi		14,504.00		14,504
4 SME-të	8			8
5 Trainimi	65			65
II Ndihamat sektoriale				2,511
6 Transporti publik	440			440
7 Shërbimet publike	645		142	787
8 Minierat	13			13
9 Energjia		1,268.50		1,269
10 Televizionet/mediat			2.89	3
TOTALI	1,194	17977.83	145	19,317

Grafiku 4. Instrumentet e dhënies së ndihmës shtetërore për vitin 2012 në %



Duhet theksuar se subvencionet në Shqipëri janë dhënë në funksion të përdorimit racional të burimeve të limituara buxhetore, për të realizuar në mënyrë efeciente programet për nxitjen e punësimit, trajnimit dhe zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Theksojmë se ndihma shtetërore për sektorin transportit publik dhe shërbimet publike është dhënë në formën e kompensimit për ofrimin e shërbimeve me interes të përgjithshëm ekonomik.

3.4 Ndihamat horizontale

Ndihamat horizontale në vitin 2012 kanë pasur një trend në rritje me 4.822,68 milionë lekë kundrejt vitit 2011, gjë që ka ardhur si pasojë e një rritjeje të ndjeshme të ndihmave për kërkim dhe zhvillim dhe asaj operacionale.


Në strukturën e ndihmës horizontale për vitin 2012, peshën më të madhe e zë ndihma për kërkim dhe zhvillim me 86 për qind, duke u ndjekur nga ndihma operacionale me 13 për qind, ndihma për trajnim me 0.39 për qind dhe ndihma për punësim me 0.14 për qind.

Tabela 8. Shpërndarja e ndihmave horizontale në Shqipëri

Ndihamat Horizontale	2008		2009		2010		2011		2012		Total	
	mln LEK	mln EUR	mln LEK	mln EUR	mln LEK	mln EUR	mln LEK	mln EUR	mln LEK	mln EUR	mln LEK	mln EUR
kursi mesatar i këmbimit		122.80		132.10		137.80		140.33		139.04		
Punësimi	80.2	0.7	72.4	0.5	53.7	0.4	37.3	0.3	23.3	0.2	266.9	2.0
Kultura	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Mjedis	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Eksporti	0.4	0.0	0.2	0.0	-	-	-	-	-	-	0.6	0.0
Ndihamat operacionale	2,989.7	24.3	2,477.5	18.8	3,119.0	22.6	2,483.5	17.7	2,205.3	15.9	13,275.1	99.3
Shpëtim dhe Ristrukturi	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Kërkim dhe Zhvillim	2,078.7	16.9	1,645.9	12.5	4,621.0	33.5	9,399.8	67.0	14,504.0	104.3	32,249.3	234.2
SME-të	12.8	0.1	21.0	0.2	16.2	0.3	-	-	8.1	0.1	58.1	0.6
Sporti	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Trajnimi	131.0	1.1	116.9	0.9	82.5	0.6	62.3	0.4	64.8	0.5	457.5	3.5
Total	5,292.80	43.10	4,333.89	32.81	7,892.46	57.46	11,982.85	85.39	16,805.53	120.87	46,307.53	339.63

Siç shihet edhe në grafikun 3, peshat e ndihmës horizontale, duke u krahasuar me vitin 2011 nuk kanë ndryshuar strukturën. Gjatë vitit 2012 ndihma horizontale përfaqëson 78.2 për qind të ndihmës shtetërore totale, duke përfshirë bujqësinë dhe peshkimin të dhënë dhe 87 për qind të ndihmës shtetërore totale nëse përfshijmë bujqësinë dhe peshkimin.

Grafiku 4. Peshat e ndihmës horizontale për vitet 2009-2012



Në ndihmën horizontale përfshihen ndihma për tregun e punës²⁵, për SME-të²⁶, për trajnim²⁷, ndihma operacionale, si dhe ndihma për kërkim zhvillim. Dy ndihmat e fundit zënë peshën më të madhe në këtë kategori.

Ndihma operacionale përfshin skemën e shtyrjes së TVSH-së për importin e makinerive dhe pajisjeve²⁸, skemën e rimbursimit të akcizës së lëndëve djegëse për prodhimin e energjisë elektrike nga termocentralet me fuqi më të madhe se 5 MW²⁹, skemën e rimbursimit të akcizës së lëndëve djegëse, të konsumuar në serat me ngrohje³⁰, si dhe skemën ekzistuese të dhënies me qira të pronave shtetërore. Kjo kategori ka pësuar një rënie nga 3,119.04 milionë lekë në vitin 2010 në 2.483,52 milionë lekë për vitin 2011 dhe për vitin 2012 në 2.205,33 milionë lekë.

Ndërsa në ndihmën për kërkim-zhvillim përfshihet skema ekzistuese e përjashtimit nga detyrimet doganore dhe TVSH-në e operacioneve hidrokarbure³¹. Sikurse u përmend dhe më lart, kjo ndihmë përbën pjesën më të madhe në kategorinë e ndihmës horizontale. Sipas raportimit të dhënës të ndihmës, për vitin 2012 volumi i punës i kryer nga kompanitë kontraktore dhe nënkontraktorët e tyre është rritur ndjeshëm duke reflektuar rritje në vlerën e totalit të përjashtimeve, kjo ndihmë përbën 67.52 për qind të ndihmës në total.

Pjesa që zë ndihma horizontale në raport me totalin e ndihmës shtetërore në vend (duke përfshirë bujqësinë, peshkimin dhe transportin), për vitet 2008, 2009, 2010 dhe 2011 krahasuar me mesataren e këtyre kategorive në BE dhe në secilin prej shteteve anëtare, paraqitet në tabelën 9.

²⁵ Vendim i KNSH nr. 9, datë 2.2.2007 "Për planin e dhënies së ndihmës shtetërore për masën e financimit, kriteret për procedurat e zbatimit të programit të praktikave profesionale për punëkërkesit e papunë, që kanë mbaruar arsimin e lartë brenda apo jashtë vendit";
Vendim i KNSH nr. 13, datë 15.3.2007 "Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit institucional";
Vendim i KNSH nr. 11, datë 15.3.2007 "Për programin e nxitjes së punësimit të punëkërkesve të papunë";
Vendim i KNSH nr. 14, datë 15.3.2007 "Për programin e nxitjes së punësimit të punëkërkesve të papunë femra".

²⁶ Vendim i KNSH nr. 10, datë 2.2.2007 "Për planin e dhënies së ndihmës shtetërore për grantin "Për krijimin e fondit shqiptar të konkurrueshmërisë"

²⁷ Vendim i KNSH nr. 12, datë 15.3.2007 "Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë"

²⁸ Vendim i KNSH nr. 17, datë 16.7.2007 Për skemën e shtyrjes së pagesës së TVSH-së makinerive dhe pajisjeve të importuara, si dhe të energjisë elektrike të importuar nga KESH sh.a.

²⁹ Vendim i KNSH nr. 25, datë 2.5.2008 "Për planin e dhënies së ndihmës shtetërore për përjashtimin nga akciza të lëndëve djegëse, të përdorura për prodhimin e energjisë elektrike nga termocentralet me fuqi më të madhe se 5 MW", i ndryshuar me vendimin e KNSH nr. 27, datë 18.8.2008

³⁰ Vendim i KNSH nr. 24, datë 2.5.2008 "Për përcaktimin e kushteve dhe procedurave për rimbursimin e akcizës së lëndëve djegëse, të konsumuar në serat me ngrohje për prodhimin e produkteve industriale dhe agroindustriale, të cilat përdoren për nevojat teknologjike të prodhimit"

³¹ Vendim i KNSH nr. 22, datë 12.12.2007 "Për përjashtimin e operacioneve hidrokarbure nga detyrimet doganore dhe TVSH"



Tabela 9. Ndihma shtetërore horizontale në Shqipëri krahasuar me mesataren e BE-së (%)

Emri i shtetit/ Viti	Shqipëria	EU-27	Belgjika	Bulgaria	Çekia	Danimarka	Gjermania	Estonia	Irlanda	Greqia	Spanja	Franca	Italia	Qipro	Letoni	Lituani	Luksemburg	Hungaria	Malta	Hollanda	Austria	Polonia	Portugalia	Rumania	Slovenia	Slovakia	Finlanda	Suedia	Anglia
2008	49	84	99	78	94	95	87	100	88	98	80	78	85	95	100	100	100	72	2	98	99	64	18	55	89	85	98	100	92
2009	80	84	100	100	89	97	88	100	89	87	79	78	85	95	100	100	100	82	23	99	99	71	19	50	93	90	99	95	93
2010	91	85	100	100	81	97	88	100	90	99	77	79	96	96	100	100	100	54	25	100	99	76	17	71	96	98	100	98	93
2011	86	90	100	100	96	93	88	100	92	10	76	98	94	96	100	100	100	71	45	100	10	71	31	10	96	96	100	100	90

3.5 Ndihma sektoriale/vertikale në Shqipëri

Në vlerë, ndihma sektoriale llogaritet në masën 2.511,39 milionë lekë (18.06 milionë euro). Gjatë vitit 2012, ndihma sektoriale në Shqipëri përfaqëson 11.69 për qind të totalit të ndihmës shtetërore duke përfshirë bujqësinë dhe peshkimin dhe 13% të totalit të ndihmës shtetërore në vend, nëse përjashtojmë bujqësinë dhe peshkimin.

Në strukturën e ndihmës sektoriale (vertikale) për vitin 2012, peshën më të lartë e zë ndihma energjinë 50.5 për qind, më pas renditet ndihma për shërbimet publike (ndihma për sektorin e ujësjellës-kanalizimeve dhe Posta Shqiptare sh.a.) me 31.3 për qind, duke u ndjekur nga ndihma për transportin publik me 17.5 për qind dhe ndihma për minierat me 0.5 për qind.

Tabela 10. Shpërndarja e ndihmës sektoriale në Shqipëri

Ndihma sektoriale	2008		2009		2010		2011		2012		Total	
	In mil LEK	In mil EUR	In mil LEK	In mil EUR	In mil LEK	In mil EUR	In mil LEK	In mil EUR	In mil LEK	In mil EUR	In mil LEK	In mil EUR
kursi mesatar i këmbimit		122.80		132.10		137.80		140.33		139.04		
Transporti publik	737.77	6.01	513.71	3.89	484.00	3.51	452.00	3.22	440.00	3.16	2,627.48	19.79
Shërbime publike	1,454.38	11.84	878.00	6.65	785.00	5.70	773.00	5.51	787.00	5.66	4,677.38	35.36
Minerat	56.92	0.46	43.27	0.33	6.00	0.04	5.00	0.04	13.00	0.09	124.19	0.96
Energjia	4,118.01	33.53	157.86	1.20	-	-	1,161.97	8.28	1,268.50	9.12	6,706.34	52.13
Televizionet/mediat	2.89	0.02	2.89	0.02	2.89	0.02	2.89	0.02	2.89	0.02	14.45	0.11
Turismi	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
TOTAL	6,369.97	51.87	1,595.74	12.08	1,277.89	9.27	2,394.86	17.07	2,511.39	18.06	14,149.85	108.35

Në vitin 2012, ndihma për shërbimet publike është dhënë në masën 787 milionë lekë, një subvencionim nga Buxheti i Shtetit si mbështetje e qeverisë për sektorin e ujësjellës-kanalizimeve me qëllim mbulimin e një pjese të kostove operacionale³² për ndërmarrjet me kapital shtetëror në masën 645 milionë lekë, si dhe për Posta Shqiptare sh.a.³³ në masën 142 milionë lekë. Ndihma për energjinë është dhënë në masën 1.268,50 milionë lekë. Në këtë kategori është përfshirë vlera e shtyrjes së TVSH-së për importin e energjisë elektrike.


Për sa i takon transportit publik ndihma shtetërore është dhënë nga Buxheti i Shtetit për mbështetjen e transportit hekurudhor, i cili ka pësuar një rënie në kohë³⁴. Mbështetja e shtetit për minierat ka pasur, gjithashtu, një rënie të dukshme gjatë viteve 2008-2012, ndërkohë që pjesa më e vogël e ndihmës sektoriale në Shqipëri, gjatë kësaj periudhe, lidhet me sektorin e transmetimit/mediatik.

³² Vendimi i KNSH nr. 5, datë 20.10.2006 “Për skemën ekzistuese të subvencionimit të ndërmarrjeve të ujësjellësit”

³³ Vendimin e KNSH nr. 36, datë 1.2.2011 “Për planin e dhënies së ndihmës shtetërore “Për kryerjen nga Posta Shqiptare sh.a. të shërbimeve postare, financiare dhe shërbimeve të tjera që janë në përputhje me aktivitetin e Posta Shqiptare sh.a. për institucionet e qeverisjes qendrore e vendore, institucionet e tjera publike, si dhe shoqëritë tregtare me kapital shtetëror”

³⁴ Vendim i KNSH nr. 8, datë 2.2.2007 “Për skemën ekzistuese të subvencionimit të hekurudhave”

Grafiku 5. Peshat e ndihmës sektoriale (vertikale) për vitet 2009-2012



Sipas grafikut 5, peshat e ndihmës sektoriale në vitin 2012, duke u krahasuar me vitin 2011 nuk kanë pësuar ndryshime për sa i takon secilës nëndarje të ndihmës; më konkretisht, ndihma për energjinë zë peshën më të madhe në totalin e ndihmës me 50.5 për qind, e pasuar nga shërbimet publike (31.3 %), transportin publik me 17.5%.

KAPITULLI 4 KONKLUSIONE

Raporti për ndihmat shtetërore për vitin 2012, i paraqitur nga Republika e Shqipërisë për BE-në dhe CEFTA-n, vjen si një zbatim i detyrimeve të sanksionura në MSA dhe në marrëveshjen e CEFTA-s 2006, për sigurimin e transparencës ndërkombëtare. Në këtë raport janë përfshirë të gjitha skemat ekzistuese apo planet të reja të ndihmës shtetërore, për të cilat Komisioni i Ndhmës Shtetërore ka dhënë vendimet përkatëse.

Struktura e ndihmës shtetërore në Shqipëri është përgjegjëse për të siguruar zbatimin e legjislacionit shqiptar për ndihmën shtetërore. Ky raport ka për qëllim që të sigurojë transparencën e dhënies dhe përdorimit të ndihmës shtetërore, të cilat kanë një peshë të konsiderueshme në burimet vendase shtetërore. Kjo strukturë bashkëpunon me dhënësin e ndihmës (institucion në nivel qendror apo lokal) në rastin kur ky i fundit i ofron mbështetje financiare apo i jep përfitim një ndërmarrjeje. Çdo mbështetje/përfitim duhet të përmbushë të gjitha kushtet e përcaktuara në legjislacionin shqiptar për ndihmën shtetërore dhe, rrjedhimisht, edhe atë të Traktatit të FEU-së. Do të konsiderohet ndihmë shtetërore e paligjshme, ndihma, e cila shtrembëron konkurrencën duke favorizuar sipërmarrje të caktuara.

Vlera e ndihmës shtetërore të dhënë në Shqipëri gjatë viteve 2007-2012 është 83.523,75 milionë lekë (≈631 milionë €). Ndhma shtetërore për vitin 2012, duke përfshirë të gjithë sektorët, arrin në vlerën 21.480,77 milionë lekë (154,49 milionë €), që përfaqësojnë 1,6 për qind të PBB-së të Republikës së Shqipërisë.

Treguesi i ndihmës shtetërore kundrejt PBB-së për vitin 2012 është 1.6 për qind, ndërsa duke përjashtuar bujqësinë, peshkimin, ndihmën individuale dhe transportin ky tregues është 1.4 %.

Rritja e vlerës së ndihmës totale për vitin 2012, në krahasim me vitin 2011, në shumën prej 4.935,5 milionë lekë ka ardhur për shkak të një rritje të ndjeshme të ndihmës për kërkim-zhvillimin dhe energji, nga ana tjetër konstatohet ulje e ndihmës shtetërore të dhënë për transportin publik, shërbimet publike dhe punësimin.

Instrumenti që zë peshën më të madhe në vitin 2012 është (A2) (ku përfshihen përjashtimet, shtyrja/ulja e normës së taksave dhe zbritja e kontributit të sigurimeve sociale) me 93 për qind, me një vlerë prej 17.977,83 milionë lekë, ndjekur nga (A1) (ku përfshihen subvencionet dhe grantet) me 6.18 për qind në vlerën prej 1.194,2 milionë lekë, ndërsa instrumenti (C2) me 0.75 për qind në vlerën prej 144,89 milionë lekë.

Ndhma horizontale për vitin 2012, llogaritet në masën 16.805,5 milionë lekë (120.87 milionë euro), me një trend në rritje prej 4.822,68 milionë lekë kundrejt vitit 2011, gjë që ka ardhur si pasojë e një rritjeje të ndjeshme të ndihmave për kërkim-zhvillim dhe asaj operacionale.



Ndihma sektoriale për vitin 2012, llogaritet në masën 2.511,39 milionë lekë (18.06 milionë euro) dhe përfaqëson 11.7% të totalit të ndihmës shtetërore, duke përfshirë bujqësinë dhe peshkimin dhe 13% të totalit të ndihmës shtetërore në vend, duke përjashtuar bujqësinë dhe peshkimin.

Qëllimi kryesor i Komisionit European për politikën e ndihmës shtetërore është: “Më pak ndihmë shtetërore dhe e orientuar më mirë”, që do të thotë se duhet të zvogëlohet shumat e përgjithshme të ndihmës shtetërore dhe të orientohet drejt përmbushjes së qëllimeve horizontale.

Raporti vjetor për ndihmën shtetërore për vitin 2012, tregon një trend pozitiv në lidhje me uljen e ndihmës sektoriale ndaj totalit të ndihmës shtetërore nga 52 % në vitin 2008 në 12% për vitin 2012. Duhet theksuar se pjesa më e madhe e ndihmave sektoriale është dhënë në formën e kompensimit për ofrimin e shërbimeve me interes të përgjithshëm ekonomik, pra është dhënë më pak ndihmë për sektorë të veçantë dhe më shumë ndihmë ndaj objektivave horizontalë, për të nxitur realizimin e objektivave të tillë të përgjithshëm, si punësimi dhe zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

Komisioni European, gjithashtu, ka iniciuar modernizimin e kontrollit të ndihmës shtetërore për shtetet e saj anëtare, fokusi kryesor është ndërgjegjësimi i dhënësve të ndihmës për politikën e kontrollit të ndihmës shtetërore për të mbështetur rritjen e qëndrueshme dhe përmirësimin e cilësisë së shpenzimeve publike duke mënjанuar shtrembërimin e konkurrencës. Gjithashtu, po kryhet një vlerësim më i kujdesshëm në rastin kur ekziston mundësia e shtrembërimit të tregut të brendshëm si pasojë e ndihmës së dhënë.

Në këto kushte duke marrë në konsideratë edhe rekomandimet e BE-së, si dhe zhvillimet në tregun e saj të brendshëm, për strukturën e ndihmës shtetërore mbetet prioritet ndërgjegjësimi i të gjithë dhënësve të ndihmës shtetërore në nivel qendror dhe lokal, për njohjen e konceptit të ndihmës shtetërore dhe përgjegjësi të tyre në zbatimin e ligjit të ndihmës shtetërore. Struktura e ndihmës shtetërore do të vazhdojë të bashkëpunojë me të gjithë dhënësit e ndihmës shtetërore, duke organizuar tryeza dhe seminare me grupet e interesit për të ofruar asistencë në zhvillimin e projekteve të ndryshme.

VENDIM

Nr. 652, datë 7.8.2013

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2013, MIRATUAR PËR MINISTRINË E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT, NË PROGRAMIN “TRANSPORTI RRUGOR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13 të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, në buxhetin e miratuar për vitin 2013, në programin “Transporti rrugor”, t’i shtohet fondi prej 200 000 000 (dyqind milionë) lekësh, për financimin e punimeve të kryera dhe të pafinancuara të objektit “Sistemi-asfaltim, rruga Kukës-Krumë, loti 2”.

2. Ky fond të përballohet nga fondi i kontingjencës i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Punëve Publike dhe Transportit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 653, datë 7.8.2013

PËR AUTORIZIMIN E SHOQËRISË “V.A.L.E. RECYCLING” SHPK, PËR IMPORTIN E MBETJEVE PËR QËLLIME RICIKLIMI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3, të nenit 22 të ligjit nr. 8934, datë 5.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar, dhe të pikës 2 të nenit 49 të ligjit nr. 10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autorizimin e shoqërisë “V.A.L.E. Recycling” sh.p.k., për importin e mbetjeve për qëllime riciklimi, me kodet e mëposhtme tarifore:

- GA 040 72 04 10 00 Mbetje dhe kthime të gizës së derdhur;
- GA 050 72 04 21 Mbetje dhe kthime të çelikeve të lidhura;
- GA 070 72.04 30 00 Mbetje dhe kthime të gizës dhe çelikut të kallajisur;
- GA 120 74 04 00 Mbetje dhe kthime të bakrit;
- GA 140 76 02.00 Mbetje dhe kthime të aluminit;
- GA 160 79 02 00 00 Mbetje dhe kthime zinku;
- GA 150 78 02 00 00 Mbetje dhe kthime të plumbit;
- GE 010 7001 00 Qelq i thyer dhe mbetje të tjera qelqi;
- GH 010 3915 Mbetjet, prerjet dhe kthimet prej plastike: etilenit, stirenit, vinil-kloridit;
- GI 010 4707 Letër apo karton i rikuperueshëm (mbetje dhe kthime);
- GL 010 44 0131 00 Tallash, mbetje dhe kthime të drurit, nëse janë apo jo të aglomeruara në kërcunj, briketa, sfera apo në forma të ngjashme: sfera prej druri;
- GJ 120 63090000 Veshje të përdorura dhe artikuj të tjerë veshjeje,

dhe kodet e listës së Bazelit: B1010, B1020, B3010, B3020, B3030, B3040, bazuar në aneksin 1, “Mbetjet e listës së gjelbër”, referuar vendimit nr. 825, datë 13.10.2010 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listave të mbetjeve që lejohen të importohen për qëllime përdorimi, riciklimi dhe përpunimi”, të ndryshuar.

2. Sasia e mbetjeve që importohet, sipas kodeve të referuara në pikën 1 të këtij vendimi, është 2000 (dy mijë) tonë në vit.

3. Mbetjet importohen nga shteti i Italisë. Transporti bëhet në rrugë tokësore dhe detare, pasi të jetë plotësuar i gjithë dokumentacioni i nevojshëm ligjor për transportin ndërkombëtar të mbetjeve, si dhe kërkesat e kreut II të vendimit nr. 806, datë 4.12.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave dhe procedurave për importimin e mbetjeve për qëllime përdorimi, përpunimi dhe riciklimi”.

4. Për çdo transfertë ndërkufitare të mbetjeve, shoqëria “V.A.L.E. Recycling” sh.p.k., dorëzon të plotësuar në Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dokumentin e lëvizjes/transfertës ndërkufitare të mbetjeve, sipas formatit të dhënë në anekset III dhe IV, bashkëlidhur vendimit nr. 825, datë 13.10.2010 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, dhe monitorimi i tyre të kryhet nga strukturat përkatëse të doganave. Çdo transfertë mbetjesh duhet të jetë e pajisur me raport-analizë, të kryer për aspektin e radioaktivitetit.

5. Periudha e lejimit të importit të mbetjeve nga shoqëria “V.A.L.E. Recycling” sh.p.k., është njëvjeçare, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.



6. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, në zbatim të kërkesave të mësipërme ligjore dhe për të siguruar mbrojtjen e mjedisit dhe të shëndetit publik, merr masat e nevojshme për kontrollin e procesit të riciklimit të mbetjeve nga shoqëria “V.A.L.E. Recycling” sh.p.k., pas miratimit të këtij vendimi.

7. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave komunikon me shkrim me shtetet eksportuese dhe ato ku do të bëhet kalimi transit i mbetjeve, për autorizimet përkatëse në bazë të të cilave lejohet kalimi i kësaj sasive të mbetjeve, në përmbushje të kërkesave të Konventës së Bazelit “Për kontrollin e lëvizjeve ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme dhe asgjësimin e tyre”, konventë në të cilën Republika e Shqipërisë është palë.

8. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

VENDIM

Nr. 671, datë 7.8.2013

**PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 180, DATË 13.2.2013 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E LISTËS SË MAKINERIVE E TË PAJISJEVE QË
JANË DREJTPËRDREJT TË LIDHURA ME INVESTIMIN DHE TË PROCEDURAVE TË
PËRJASHTIMEVE E TË KRITEREVE PËRKATËSE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjave “g”, “gj” e “i” të nenit 261/1, të ligjit nr. 7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në aneksin 1 që i bashkëlidhet vendimit nr. 180, datë 13.2.2013 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të shtohen edhe kodet sipas aneksit 1/1 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

ANEKSI 1/1

Kodet NK	Përshkrimi
3917 23 90	Të tjera
3917 33 00	Të tjera jo të përforcuara apo të kombinuara ndryshe me materiale të tjera me pajisje shtesë
7304 29 90	Të një diametri më tepër se 406,4 mm
7304 39 98	Tuba të një seksioni kryq rrethor, prej gize apo çeliku jo të lidhur me diametër të jashtëm më tepër se 406,4 mm
7304 49 99	Tuba të një seksioni kryq rrethor, prej çeliku të pandryshkshëm të një diametri të jashtëm më tepër se 406,4 mm
7304 59 99	Tuba të një seksioni kryq rrethor, prej çelikeve të tjera të lidhur të një diametri të jashtëm më tepër se 406,4 mm
7305 31 00	Të salduar për së gjati
7308 20 00	Kullat dhe shtylla për grilla
7311 00 99	1000 litra apo më shumë
8412 21 80	Motorë hidraulikë ndryshe nga turbo-reaktivët
8414 59 20	Ventilator aksial
8414 59 40	Ventilator centrifugal
8428 20	Elevatorët dhe kovejeret pneumatike
8428 10	Ashensorët e minierave
8431 31 00	Pjesët e ashensorëve të minierave apo eskalatorëve
8431 43 00	Pjesët për makineritë shpuese apo zhytëse të nënkreut 8430 41 apo 8430 49
8431 49 20	Pjesë të makinerive të kreut 8426, 8429 apo 8430, prej gize të derdhur apo çeliku të derdhur
8437 90 00	Pjesët
8467 22 10	Sharra elektrike me zinxhirë
8467 22 30	Sharrë disk
8474	Makineri për zgjedhjen, shoshimin, veçimin, larjen, therimin, bluarjen, përzierjen e oksideve, gurëve, xeheroreve ose substancave të tjera minerale në formë të ngurtë (përfshi në formë pudre ose paste); makineri për aglomerimin, dhënien formë ose kallëp i lëndëve djegëse të ngurta minerale, pastave qeramike, çimentove të pakalitura, materialeve plastifikuese apo produkteve të tjera minerale në formë pluhuri apo paste; makinat për modulet e formimit të fonderisë apo të rërave
8503 00 99	Pjesët e përshtatshme për t'u përdorur vetëm ose kryesisht me makinat e kreut 8501 ose 8502, të ndryshme nga prej gize të derdhur apo çeliku të derdhur
8504 40 88	Që kanë një kapacitet të mbajtjes së energjisë më tepër se 7,5 kVA
8535 40	Rrufepritësit, kufizuesit e tensionit dhe zbutësit e mbitensionit
8535 40 00	Rrufepritësit, kufizuesit e tensionit dhe zbutësit e mbitensionit
8601 10 00	Të fuqizuara nga një burim elektrik i jashtëm
8601 20 00	Të fuqizuara nga akumulatorët elektrikë
8602 10 00	Lokomotivë diezel-elektrik
8602 90 00	Të tjera
8603 10 00	Të fuqizuara nga një burim elektrik i jashtëm
8604 00 00	Mjetet lëvizëse të mirëmbajtjes ose të shërbimit të hekurudhave ose të tramvajeve, nëse janë apo jo vetëlëvizëse (p.sh.: punishtet, vinçat, gatitësit e zhavorrit, linjëzuesit e shinave, vagonët e testimit dhe mjetet lëvizëse për inspektimin e rrugës hekurudhore)
8605 00 00	Vagonët e pasagjerëve të hekurudhës dhe tramvajeve, jovetëlëvizës; vagonët e bagazhit, vagonët e postës dhe vagonët për qëllime të tjera speciale të hekurudhës ose tramvajit, jovetëlëvizës
8606 10 00	Vagonë cisterne dhe të ngjashëm
8606 30 00	Vagonë dhe vagoneta



8606 91 10	Të projektuara posaçërisht për transportin e materialeve shumë-radioaktive (Euratom)
8606 91 80	Të tjera
8606 92 00	Të hapur, me faqet anësore të palëvizshme të një lartësie që e kalon 60 cm (vagonë dhe vagoneta)
8606 99 00	Të tjera (vagonë dhe vagoneta)
8607 11 00	Vagonetat dhe bissel-vagonetat drejtuese
8607 12 00	Vagonetat dhe bissel-vagonetat e tjera
8607 19 10	Boshtet, nëse janë ose jo të montuara, rrotat dhe pjesët e tyre
8607 19 90	Pjesët e vagonetave, bissel-vagonetave dhe të ngjashmet
8607 21 10	Frenat me ajër dhe pjesët e tyre me derdhje gize apo me derdhje çeliku
8607 21 90	Të tjera
8607 30 00	Lidhësit me grep dhe pajisje të tjera lidhjeje, amortizatorët dhe pjesët e tyre
8607 91 10	Kutitë e aksit dhe pjesët e tyre
8607 91 90	Të tjera
8607 99 10	Kutitë e aksit dhe pjesët e tyre
8607 99 80	Të tjera
8608 00 00	Armaturat dhe fiksuesit e shinave hekurudhore ose tramvajeve; sinjalizuesit mekanikë (përfshi elektromekanikë), pajisje mbrojtjeje ose kontrolli trafiku për hekurudhat, tramvajet, rrugët, rrugët ujore brenda vendit, pajisjet e parkimit, instalimet në port ose aeroporte
8609 00 10	Kontejnerë me një mbulesë plumbi kundër rrezatimit, për transportin e materialeve radioaktive (Euratom)
8609 00 90	Të tjera

URDHËR

Nr. 109, datë 5.8.2013

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR KUSHTET, KRITERET DHE PROGRAMET PËR PËRGATITJEN TEORIKE-PRAKTIKE TË KANDIDATËVE, SI DHE DHËNIEN E DËSHMISË SË AFTËSISË PROFESIONALE PËR PËRDORUESIT E MAKINERIVE TË RËNDA PËR PUNIME NDËRTIMI DHE TOKE, SI DHE DISIPLINIMI I PËRDORIMIT TË MAKINERIVE TË NDËRTIMIT”

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, të pikës 2/b të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 808, datë 4.12.2003 “Për dhënie të lejeve të manovrimit të përdoruesve të makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimit në tokë”, të ndryshuar, me propozimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teorike-praktike të kandidatëve, si dhe dhënie të dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor për zbatimin e këtij urdhri.

3. Urdhri nr. 47, datë 29.3.2010 shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi

RREGULLORE
PËR KUSHTET, KRITERET DHE PROGRAMET PËR PËRGATITJEN TEORIKE-PRAKTIKE
TË KANDIDATËVE, SI DHE DHËNIEN E DËSHMISË SË AFTËSISË PROFESIONALE PËR
PËRDORUESIT E MAKINERIVE TË RËNDA PËR PUNIME NDËRTIMI DHE TOKE, SI DHE
DISIPLINIMI I PËRDORIMIT TË MAKINERIVE TË NDËRTIMIT

KREU I
QËLLIMI, OBJEKTI I RREGULLORES DHE FUSHA E VEPRIMIT

Neni 1

Kjo rregullore ka për qëllim vendosjen mbi baza unike e ligjore të aktivitetit, administrimit dhe përdorimit të makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre në zbatim të rregullave të sigurimit teknik.

Neni 2

Kjo rregullore përcakton kushtet, kriteret dhe shtrirjen e fushës së veprimit të saj, për:

1. Persona fizikë (individë), të cilët kërkojnë të pajisen me dëshminë e aftësisë profesionale, për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, bazuar në përvetësimin e kurseve teorike e praktike që kryhen nga subjekte juridike, si dhe organizimin e komisionit të marrjes në provim.

2. Vendosjen e rregullave të administrimit, organizimit dhe përdorimit të makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke nga subjekte ose persona që i kanë në pronësi ose me qira.

3. Përkufizime

a) “Dëshmia e aftësisë profesionale DAP” - dokument që provon se personi zotëron njohuri të mjaftueshme teorike-praktike për përdorimin e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, ku hyjnë të gjitha makineritë teknologjike, të cilat janë makina vetëlëvizëse ose që tërhiqen, me rrota ose me zinxhirë.

b) “Subjekt juridik” që mund të jenë subjekte juridike, ose subjekte ndërtuese, apo ente, të aftë të plotësojnë kushtet për të kryer zhvillimin e mësimave teorike-praktike, me qëllim kualifikimin e përdoruesve të makinerive të rënda të ndërtimit, të cilët duhet të jenë të pajisur me licencë sipas nenit 5 të kësaj rregulloreje.

c) “Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor” (DPSHTRR) është organi që jep dëshminë e aftësisë profesionale (DAP), në përputhje me përcaktimet e pikës 3/a dhe 3/b të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 808, datë 4.12.2003, të ndryshuar.

KREU II
E DREJTA DHE KUSHTET E VEPRIMTARISË SË SUBJEKTIT JURIDIK

Neni 3

Subjekti juridik do të shërbejë për të kryer zhvillimin e kurseve të trajnimit të vazhdueshëm teorike-praktike, të kandidatëve që dëshirojnë të pajisen me dëshminë e aftësisë profesionale (DAP), si përdorues të makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke.

Veprimtaria e subjektit juridik është tërësia e funksionimit në zhvillimin e kurseve teorike-praktike në të gjitha komponentët bazë që përfshijnë:

1. ambientet për zhvillimin e mësimdhënies të kursit teorik;
2. mjetet për kursin praktik;



3. mësuesit e teorisë dhe instruktorët e praktikës.

Subjektet juridike duhet të kenë në pronësi ose me qira, makineri të rënda ndërtimi të tipit sipas nenit 6 të kësaj rregulloreje, respektivisht sipas kursit të trajnimit që do të zhvillojnë.

Gjatë kryerjes së veprimtarisë, subjekti juridik duhet të mbajë dhe të plotësojë rregullisht e me vërtetësi këto dokumente:

1. regjistrin e evidentimit të kandidatëve për përdorues të makinerive të rënda të ndërtimit (amza);

2. regjistrin e zhvillimit të kursit teorik në klasë dhe atij praktik.

Neni 4

Drejtnesit teknikë të subjekteve juridike janë përgjegjës për administrimin dhe organizimin e përdorimit të makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë, në funksion të përgatitjes e kualifikimit profesional nëpërmjet kurseve teorike-praktike të personelit përdorues të tyre.

Neni 5

Përgatitja teorike dhe praktike e përdoruesve të makinerive të rënda të ndërtimit zhvillohet pranë subjekteve juridike, të cilat duhet të pajisen me licencë për këtë qëllim.

Subjektet juridike licencohen duke plotësuar kushtet e përcaktuara në nenin 121 të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë dhe nenin 313 pika 3 e rregullores në zbatim të Kodit Rrugor.

Trajnimi në kursin teorik-praktik i aplikantëve, sipas përcaktimeve të pikave 5/a dhe 5/b të nenit 8 dhe pikave 4, 5/a, 5/b dhe 5/c të nenit 9 të kësaj rregulloreje, kryhet nga instruktorët e teorisë dhe të praktikës, të punësuar pranë subjekteve juridike, për të mundësuar përvetësimin nga ana e tyre të njohurive të plota teorike-praktike në funksionimin e këtyre makinerive, për rreziqet në punë dhe masat e sigurimit teknik për evitimin e tyre.

KREU III

KRITERET PËR KLASIFIKIMIN DHE EMËRTIMIN E MJETEVE TË RËNDA TË NDËRTIMIT DHE PUNIMIT TË TOKËS DHE LËSHIMIT TË DËSHMISË SË AFTËSISË PROFESIONALE (DAP)

Neni 6

Në kuptimin e kësaj rregulloreje, makineritë e ndërtimit ndahen në dy grupe, si:

1. makineri të rënda të punimeve të ndërtimit që përfshijnë grupin e makinerive që paraqesin vështirësi të larta teknologjike e teknike në përdorimin dhe mirëmbajtjen e tyre;

2. makineri të tjera ndërtimi që përfshijnë të gjitha llojet e makinerive të ndërtimit e të prodhimit të materialeve të ndërtimit, të cilat nuk përfshihen në grupin e parë.

Neni 7

1. Makineritë e rënda të ndërtimit dhe emërtimet bëhen sipas dëshmive të aftësie profesionale (DAP), të cilat ndahen si më poshtë:

a) makineri gjurmimi e ngarkimi dherash: vetëshkarkues, ngarkues-transportues, ekskavatorë, fadroma, ekskavatorë të kombinuar me pajisje shtesë, lopata ngarkuese (me goma dhe me zinxhirë), manovratorëve u jepet dëshmi për ekskavatoristë (për mjete me goma ose me zinxhirë);

b) makineri gjurmimi, shtyrje, nivelimi e ngjeshje dherash apo shpim toke: buldozerë, traktorë, skreper, greidera (nivelues), rulo vibruës, shtruese asfalto-betoni, sonda shpimi vetëlëvizëse, manovratorëve u jepet dëshmi për buldozeristë (me goma ose me zinxhirë);

c) makineri ndërtimi mbi bazë automjeti: autovinça, autobetoniere, autobetonpompa, autobitumatrine, autosonda, manovratorëve u jepet dëshmi për automakinistë.

2. Përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit me rrota gome, përpara se të marrin dëshminë e aftësisë profesionale, duhet të jenë pajisur detyrimisht edhe me leje drejtimi automjetesh të lëshuar nga DPSHTRR-ja, konform nenit 122 të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

KREU IV ORGANIZIMI I TRAJNIMIT DHE DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM

Neni 8 **Zhvillimi i kursit teorik**

Ambientet e subjektit juridik (klasat) për zhvillimin e mësimi teorik duhet të plotësojnë të gjitha kushtet me këto të dhëna, si:

1. Të ketë ambient të mjaftueshëm dhe funksional me kapacitet jo më pak se 10 vende, i kompletuar me tavolina dhe ndenjës të përshtatshme me hapësira optimale, si dhe të ketë vend për mësuesin e kursit teorik.

2. Të ketë ndriçim dhe ventilim të mjaftueshëm, si dhe ambiente hidrosanitare me parametra standardë dhe me ujë të vazhdueshëm.

3. Të ketë pajisje didaktike të ndryshme për demonstrimin e manovrimeve nga përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit dhe të punimeve në tokë, ku këto njohuri të jenë fituar gjatë periudhës së kryerjes së kursit teorik, si:

a) tabelë shkrimi, stenda apo makete, pllakata etj., për demonstrimin e manovrimeve nga përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit në kushtet e një kryqëzimi ose rrethrotullimi në rrugë qytetëse, kantiere ose jo qytetëse;

b) tabela me figura të ndryshme të tipave për makineritë e rënda ndërtimi, si: vetëshkarkues, ngarkues-transportues, autobetonjere, buldozer, fadroma, automakineri-shpimi, ekskavator me zinxhirë, ekskavator me zinxhirë hidraulikë për hapje kanalesh, autoskraper për punime rrugësh, makinë niveluese, rul vibruar, automakineri betonshtuese, automakineri asfaltuese etj.;

c) makete makinerish ndërtimi të ndryshme, të zbërthyer në pjesë të veçanta, modele agregatësh apo nyje të zbërthyer nga mjete origjinale të sistemeve të ndryshme kryesore të makinerive të rënda të ndërtimit dhe të punimeve në tokë;

d) subjekti juridik duhet të pajisë klasat e mësimi teorik me mjete audiovizive për të bërë më të kuptueshëm dhe konkret demonstrimin e programit, si dhe dy kompjuterë për qëllim mësimi të kandidatëve.

4. Koha e mësimdhënies për kursin teorik duhet të jetë 16 orë, të cilat do të zhvillohen në 8 ditë me nga 2 orë secila.

5. Kursi teorik do të zhvillohet mbi bazën e programit mësimor pjesë e kësaj rregulloreje dhe do të kryhet:

a) në të gjitha subjektet që kanë aktivitet të vetëm atë të autoshkollës, nga inxhinierë mekanikë në përputhje me përcaktimet e nenit 121 të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të pajisur me dëshminë përkatëse që lëshohet nga DPSHTRR-ja. Vijueshmëria e kursit teorik dhe pjesëmarrja e kandidatëve dokumentohen në regjistrin e zhvillimit të programit teorik përkatës model DL26, njësoj si për kandidatët që kërkojnë të pajisen me një kategori të caktuar leje drejtimi;

b) në të gjitha subjektet që kanë aktivitet kryesor punimet e ndërtimit dhe tokës, si dhe kryejnë aktivitetin e përgatitjes së kandidatëve për manovratorë të mjeteve të rënda për punime ndërtimi dhe toke, nga drejtuesit teknikë, inxhinierë mekanikë, të cilët janë përgjegjës për administrimin dhe organizimin e përdorimit të këtyre makinerive.



Neni 9 Zhvillimi i kursit praktik

1. Subjektet juridike ose subjekte ndërtuese duhet të kenë në pronësi ose me qira, makineri të ndryshme ndërtimi dhe punimeve në tokë të përshtatshme që plotësojnë kushtet për kursin praktik të kandidatëve, si përdorues të makinerive të rënda të ndërtimit dhe të punimeve në tokë, sipas nenit 7 të kësaj rregulloreje.

2. Makineritë e rënda të ndërtimit që plotësojnë kriteret sipas pikës 1 të këtij neni, duhet të jenë të pajisur nga Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor me autorizimin përkatës për “Mësimore” të specializuara në zhvillimin e kursit praktik për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit dhe të punimeve në tokë, si dhe të jenë të evidentuara në regjistrin përkatës të drejtorisë rajonale sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja.

3. Kandidatët duhet të kryejnë kursin praktik me makineri të rënda ndërtimi dhe punimeve në tokë, sipas përkufizimeve dhe mënyrave të përcaktuara nga aktet në zbatim të Kodit Rrugor.

4. Çdo subjekt juridik ose subjekte ndërtuese, duhet të ketë instruktorin e praktikës, të jetë pajisur me dëshminë e aftësisë profesionale përkatëse dhe me eksperiencë pune jo më të vogël se 5 vjet. Instruktorët e praktikës zhvillojnë sipas programit të miratuar kurset përkatëse dhe vijueshmërinë dhe përgatitjen e kursantëve e dokumentojnë në regjistrin e zhvillimit të kursit praktik. Model DL27.

5. Përgatitja praktike e kandidatëve, në të gjitha rastet, do të bëhet në ambiente të përshtatshme si më poshtë:

a) fillimisht në fushë, rrugë e mjedise të pabanuara, ku nuk ka lëvizje të dendra për të praktikuar komandat bazë në lëvizjen e makinerive para dhe mbrapa; kthimet në vend dhe në lëvizje; komandimin e lehtë të agregateve të makinerive pa ngarkesë; pozicionimin e tyre sipas punimeve që do të kryejnë;

b) për të garantuar një lëvizje të sigurt nga ambientet e strehimit në kantieret e punës, kur nuk është i nevojshëm transporti me rimorkiator, do të praktikohet fillimisht lëvizja e tyre në rrugë jashtë qendrave të banuara, ditën dhe natën; kur do të jetë i nevojshëm transporti me rimorkiator apo me mjete të tjera do të praktikohet ngarkimi i tyre në këto mjete, fiksimi dhe sigurimi dhe zbritja pa avari;

c) në kantieret e ndërtimit për të praktikuar lëvizjet, pozicionimin dhe përgatitjen e mjetit për të filluar procedurën e punimit përkatës; gjurmimet për thellim të sipërfaqes, rievimit, spostimit dhe transportit të dherave, për kanale dhe themele etj.; ngarkimin e mjeteve me mbeturina të ngurta apo inerte; përgatitjen dhe transportin e betoneve nga fabrikat e prodhimit në objektin që ndërtohet etj.

6. Koha e përgatitjes për kursin praktik, për çdo kandidat të jetë 8 orë, pra 1 (një) orë në ditë, i cili duhet të zhvillohet pas mësimit teorik.

7. Numri maksimal i kandidatëve që lejohen të ushtrohen në një cikël me një mjet (makineri të rënda ndërtimi) dhe një instruktor, për çdo lloj makinerie, nuk duhet të jetë më shumë se 8 veta.

8. Makineritë e rënda të ndërtimit vetëlëvizëse me goma, duhet të jenë me pamje të jashtme të rregullta dhe në gjendje të mirë teknike, të pajisura me certifikatën e kontrollit teknik dhe të regjistruara me leje qarkullimi nga drejtoritë rajonale të shërbimeve të transportit rrugor.

Neni 10

Për të provuar aftësitë profesionale të manovratorëve të makinerive të rënda të ndërtimit, që aplikojnë për të marrë dëshmi aftësie profesionale, ngrihet një komision i posaçëm, me inxhinierë mekanikë të DPSHTRR-së.

KREU V REGJISTRIMI DHE ORGANIZIMI I TESTIMIT

Neni 11 Regjistrimi i kandidatëve

1. Kandidatët regjistrohen nëpërmjet subjekteve juridike pranë zyrave përkatëse të drejtorive rajonale të shërbimeve të transportit rrugor, që mbulojnë vendbanimin e tyre.

Nëse në rrethet që mbulon një drejtori rajonale nuk ka subjekte të licencuara që kryejnë aktivitetin e përgatitjes së kandidatëve për përdorues të mjeteve të rënda për punime ndërtimi dhe toke, kandidatët mund të zgjedhin çdo subjekt tjetër të licencuar për të bërë regjistrimin dhe kryerjen e kursit teorik dhe praktik.

2. Çdo kandidat duhet të ketë në dosjen e tij, të plotësuar autorizimin përkatës të lëshuar nga DRSHTRR-ja që i është bashkëngjitur kësaj rregulloreje, përpara se të fillojë kursin teorik e praktik duke paraqitur dhe këto dokumente:

- certifikatë personale me foto dhe 4 fotografi 4.2 x 3.5;
- fotokopje e kartës së identitetit;
- vërtetim banimi;
- fotokopje e lejes së drejtimit për mjetet, të cilat kërkohet leje drejtimi në bazë të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, neni 115 pika 3.

3. Kandidati, i cili do të regjistrohet duhet të ketë mbushur moshën që i korrespondon pajisjes me lejedrejtimi sipas neneve 114 dhe 115 të Kodit Rrugor.

4. Në përfundim të kursit të plotë teorik-praktik të zhvilluar, drejtuesit teknikë, subjekteve juridike që plotësojnë kriteret sipas pikës 1 neni 5, përpilojnë listat e kandidatëve që janë të aftë t’i nënshtrohen provimit dhe ia dërgojnë ato DPSHTRR-së, e cila njofton për orën, datën dhe vendin ku do të zhvillohet provimi i radhës.

Neni 12 Zhvillimi i provimit

1. Me urdhër të veçantë të drejtorit të përgjithshëm, krijohet komisioni i posaçëm i marrjes në provim të kandidatëve për përdorues të mjeteve të rënda për punime ndërtimi dhe toke, i cili përbëhet nga 3 specialistë, inxhinierë mekanikë të DPSHTRR-së.

2. Marrja në provim e kandidatëve për përdorues të mjeteve të rënda për punime ndërtimi dhe toke, bëhet pasi ata të kenë deklaruar se kanë kryer kursin teorik dhe praktik sipas përcaktimeve të pikës 4 të nenit 8 dhe pikës 6 të nenit 9 të kësaj rregulloreje.

3. Testet e provimit përgatiten nga specialistët e DPSHTRR-së, në përputhje me programin e miratuar bashkëngjitur kësaj rregulloreje.

4. Komisioni i provimit, i ngritur me urdhër të drejtorit të përgjithshëm, merr në dorëzim materialet e parashikuara për funksionimin e rregullt të provimit:

- a) regjistrin e protokollit;
- b) testet e provimit, të miratuara nga drejtori i përgjithshëm;
- c) listat emërore të kandidatëve që do t’i nënshtrohen provimit, të paraqitura para provimit nga subjektet përkatëse që kanë kryer përgatitjen e tyre së bashku me dosjet përkatëse të kandidatëve dhe pasi verifikon rregullueshmërinë e tyre, fillon seancën përkatëse të provimit.

5. Çdo kandidat i nënshtrohet një provimi të detyrueshëm me anë të plotësimit të një testi (pyetësori), i cili përbëhet nga 10 pyetje me 3 alternativa, të vlerësuara me nga një pikë secila.

6. Që të shpallet fitues i provimit, kandidati duhet t’i japë përgjigje korrekte të paktën 8 pyetjeve nga 10 të tilla që përmban testi.



7. Kandidati i vlerësuar fitues në testim, pajiset me dëshminë e aftësisë profesionale.
8. Kandidatët nuk mund të merren në provim pa realizuar programin e plotë teorik-praktik, të vërtetuar nga subjekti juridik privat.
9. Komisioni i marrjes në provim nuk duhet të marrë më shumë se 20 kandidatë në seancë. Numri i seancave përcaktohet nga numri i kandidatëve të paraqitur nga subjektet e licencuara. Koha e provimit (seanca) është 1 (një) orë.
10. Kandidatët kanë të drejtë të paraqiten deri në pesë herë në provim, brenda afatit të vlefshmërisë së autorizimit, i cili është 1 (një) vit, por nga një provim me rezultat negativ në tjetrin, duhet të kalojnë të paktën 30 ditë.
11. Provimi mund të zhvillohet edhe në ambientet e subjekteve private, nëse ata kanë të paktën 8 kandidatë për testim. Kur numri i kandidatëve të një subjekti është më i vogël se 8, DPSHTRR-ja mund të organizojë testimin e tyre duke bashkuar kandidatët e më shumë se një subjekti. Në këtë rast, testimi do të kryhet në ambientet e subjektit që ka numrin më të madh të kandidatëve, duke i njoftuar ata paraprakisht. Në varësi të numrit të seancave të mundshme, testimi duhet të fillojë në orën 10:00 deri në 16:00.
12. Dokumenti bazë për marrjen në provim të kandidatëve është libri i protokollit, ku hidhen të gjitha rezultatet në ditët e planifikuara nga komisioni i marrjes në provim, i cili harton procesverbalin përfundimtar të firmosur prej tyre.
13. Të dhënat e çdo aplikanti të shpallur fitues në provimin përkatës, si dhe të dhënat e dëshmisë së fituar prej tij, hidhen në regjistrin kombëtar kompjuterik.

Neni 13

Pajisja me dëshminë e aftësisë profesionale

1. Kandidatët, të cilët kryejnë sipas programit kurset e trajnimit teorik-praktik, si përdorues të makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë, si dhe kalojnë me sukses provimin sipas nenit 12, përfitojnë dëshminë e aftësisë profesionale, sipas nenit 7 pika 1, si manovratorë të makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimit në tokë.
2. Dëshmia e aftësisë profesionale lëshohet në përputhje me modelin e paraqitur nga DPSHTRR-ja dhe e miratuar nga ministria që mbulon transportin.
3. Dëshmia e aftësisë profesionale është e vlefshme me afat 5-vjeçar, nga data e lëshimit dhe shfrytëzohet vetëm për ato qëllime për të cilat ajo është lëshuar.
4. Çdo korrigjim e bën dëshminë të pavlefshme.
5. Ky dokument pezullohet nga organi që e lëshon.

Neni 14

Rinovimi i DAP-it

1. Kur mbajtësi i një dëshmie të aftësisë profesionale (DAP) kërkon rinovimin e dëshmisë kur është mbushur afati i vlefshmërisë, duhet të bëjë një kërkesë me shkrim në sektorin përkatës të DPSHTRR-së dhe të shoqëruar me dëshminë origjinale. Në të gjitha rastet, dëshmitë e aftësisë profesionale të lëshuara nga Ministria e Bujqësisë, Ministria e Ndërtimit, Shoqata Kombëtare e Ndërtuesve apo dhe nga çdo institucion tjetër i autorizuar para datës 23.3.2012, do të pranohen të rinovohen vetëm nëse i interesuari do të paraqesë në origjinal dëshminë që disponon.
2. Kur mbajtësi i një dëshmie të aftësisë profesionale (DAP) kërkon zëvendësimin për shkak të humbjes së saj, kërkesa duhet të bëhet me shkrim me sqarime të hollësishme mbi humbjen e saj, e shoqëruar dhe me një vërtetim për deklarimin e humbjes nga komisariati i policisë ku ai banon. Nëse dëshmia e humbur nuk është lëshuar nga DPSHTRR-ja, i interesuari duhet të paraqesë dhe një vërtetim zyrtar, të lëshuar nga institucioni që ka lëshuar dëshminë, në të cilin të përmendet lloji i dëshmisë ose në mungesë të tij, kopje e librezës së punës të noteruar, ku është shënuar profesioni.

3. Kur mbajtësi i një dëshmie të aftësisë profesionale (DAP), kërkon zëvendësimin për arsye të dëmtimit të saj, duhet të paraqesë kërkesën përkatëse të shoqëruar dhe me dëshminë e dëmtuar, e cila:

a) nëse është e palexueshme, por e lëshuar nga DPSHTRR-ja, duhet të pranohet pasi të jetë kontrolluar vërtetësia e saj në librin e protokollit përkatës;

b) nëse është e palexueshme, por e palëshuar nga Ministria e Bujqësisë, Ministria e Ndërtimit, Shoqata Kombëtare e Ndërtuesve apo dhe çdo institucion tjetër i autorizuar, para datës 23.3.2010, duhet të shoqërohet dhe me një vërtetim zyrtar, të lëshuar nga institucioni që e ka lëshuar, në të cilin të përmendet lloji i dëshmisë.

4. Rinovimi apo zëvendësimi i dëshmisë, lëshohet kur plotësohen kërkesat e mësipërme dhe kur janë shqyrtuar dhe verifikuar në protokollin përkatës që gjendet në arkivin e DPSHTRR-së.

5. Kërkesat e kandidatëve për rinovimin e dëshmisë së aftësisë profesionale depozitohen pranë drejtorive rajonale, që mbulojnë vendbanimin e tyre.

6. Drejtoritë rajonale, kërkesat për shërbimin e rinovimit apo zëvendësimit të dëshmimeve, së bashku me dokumentacionin përkatës, ia përcjellin për kompetencë drejtorisë që mbulon kualifikimet profesionale në DPSHTRR.

7. Drejtoria që mbulon kualifikimet profesionale në DPSHTRR, shqyrton kërkesat për rinovimin e dëshmimeve të aftësisë profesionale, të paraqitura nga drejtoritë rajonale, dhe kur i shikon në përputhje me kërkesat e kësaj rregullore kryen rinovimet përkatëse. Nëse dëshmitë e lëshuara para datës 23.3.2012, nuk përputhen me kategoritë e lejes së drejtimit që zotërojnë mbajtësit e tyre, referuar pikës 2 të nenit 7 të rregullores, këto dëshmi do të rinovohen vetëm pasi mbajtësit e tyre të jenë pajisur me kategorinë përkatëse të lejes së drejtimit.

KREU VI DISIPLINIMI I PËRDORIMIT TË MAKINERIVE TË NDËRTIMIT DHE RREGULLAT E SIGURIMIT TEKNIK

Neni 15

Në zbatim të nenit 18 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, kërkohet në të njëjtën kohë përcaktimi i klasifikimit sipas tipave të makinerive të rënda të ndërtimit, që:

1. Mjetet e ndërtimit sipas nenit 58 të Kodit Rrugor, janë makineri teknologjike vetëlëvizëse ose që tërhiqen, me rrota ose me zinxhirë. Këto makineri janë të destinuara të operojnë mbi rrugë dhe në kantiere dhe mund të jenë të pajisura me mekanizma specialë.

2. Këto mjete mund të lëvizin në rrugë për të kaluar nga një vend pune në tjetrin ose për të zhvendosur sende që lidhen me ciklin e punës së vetë makinës ose të kantierit, sipas kufizimeve dhe mënyrave të përcaktuara në aktet nënligjore.

3. Sipas qëllimeve të qarkullimit rrugor dhe disiplinimit të tyre, makineritë e ndërtimit dhe punimeve në tokë klasifikohen në:

a) mjete ndërtimi vetëshkarkuese, ngarkues-transportues, autobetonjere, buldozer, automakineri shpimi, ekskavator me zinxhirë, ekskavator me goma, ekskavator me zinxhirë hidraulikë dhe ekskavatorë hidraulikë me zinxhirë për hapje kanalesh;

b) mjete ndërtimi rrugësh autoskrejper ngarkimi, transportimi, shkarkimi, grejder (autoshatë niveluese), rul-vibrues, automakineri betonshtuese dhe automakineri asfaltuese;

c) mjete të destinuara për lëvizjen e sendeve, si motopirunët dhe elektropirunët etj.



Neni 16

Për të mundësuar lëvizjen në rrugë dhe për të shmangur aksidentet, mjetet për të cilat bën fjalë neni 7 i kësaj rregulloreje duhet të qarkullojnë në përputhje me përcaktimet e nenit 113 të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Neni 17

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor ushtron kontroll dhe inspektime mbi veprimtarinë e subjekteve të licencuara, duke iu referuar nenit 121 pika 8 dhe 9. Përbëjnë kontroll veçanërisht:

- a) aftësia profesionale e personelit trajnues;
- b) gjendja e makinerive të ndërtimit sipas normave në fuqi;
- c) plotësimi i pajisjeve didaktike;
- d) përshtatshmëria e mjediseve;
- e) kryerja e rregullt e kurseve të trajnimit teorik-praktik etj.

Neni 18

Disiplinimi i makinerive të ndërtimit dhe punimeve në tokë, karakterizohet nga lloji i tyre, konstruksioni, mënyra e përdorimit, si dhe qarkullimi me ose pa pajisjet e punës, të njohura nga qendra e miratimit apo homologimit si të çmontueshme, me kusht që për çdo rast të respektohen kufijtë e përmasave dhe ndërmjet peshës ose peshave që rëndojnë mbi aksin ose akset e përparme, si dhe të atyre që rëndojnë mbi aksin ose akset e pasme.

Neni 19

Makineritë e ndërtimit në disa raste quhen mjete zhvendosëse, kur përdoren për transporte të kombinuara apo sipas lëvizjes së tyre në zonat, si: në kantiere ndërtimi, rrugë, autostrada, ndërtim digash në hidrocentrale, porte, aeroporte ose vepra të tjera bonifikuese, të caktuara për të lidhur dy ose më shumë nga zonat, edhe kur ato janë ndërprerë nga zonat publike.

Neni 20

Subjektet ndërtimore ua dorëzojnë me procesverbal makineritë, vetëm përdoruesve të pajisur me dëshmi aftësie profesionale, të cilët e shfrytëzojnë, mirëmbajnë dhe përgjigjen për dëmet që shkaktohen për faj të tyre. Procesverbal i firmoset nga drejtuesit e shoqërisë dhe nga përdoruesi marrës në dorëzim.

Neni 21

Procesverbal i marrjes në dorëzim të makinerisë dhe dëshmia e aftësisë profesionale (DAP) janë dokumente teknike që duhet të mbahen detyrimisht nga përdoruesi gjatë gjithë kohës që shfrytëzon makineritë. Ato paraqiten sa herë që kërkohet nga personat e ngarkuar për kontroll. Ndalohe shfrytëzimi i makinerisë nga përdoruesit pa qenë të pajisur me këto dokumente.

Neni 22

Për mjetet ngritëse, si: vinç-kullë, vinç-derik, vinç-stacionar, ashensorë, çmontimi dhe montimi në objektin e ri, do të bëhet me specialistë, nën mbikëqyrjen e drejtuesit teknik të shoqërisë dhe një inxhinier mekanik i pajisur me licencë, të cilët do të asistojnë dhe do të kontrollojnë të gjitha

regjistrimet dhe provat që duhet të plotësojnë këto makineri (prova pa ngarkesë dhe me ngarkesë) për të qenë të gatshme për punë. Në përfundim të provave mbahet një procesverbal ndërmjet drejtuesit teknik të subjektit, specialistëve të montimit, inxhinierit mekanik dhe manovratorit.

Neni 23

Përdoruesi i mjetit çdo ditë para fillimit të punës provon gjendjen teknike të makinerisë duke e vënë atë në lëvizje. Nëse konstaton ndonjë mungesë ose defekt, ndalon makinerinë dhe lajmëron personat përgjegjës. Ndalohet fillimi dhe vazhdimi i punës me makineri të defektuara dhe me mungesa.

Neni 24

Subjektet ndërtimore janë të detyruara të japin udhëzime mbi rregullat e sigurimit teknik dhe rregullat e shfrytëzimit të makinerive që janë në përdorim jo më pak se një herë në tre muaj.

Neni 25

Në rastin kur makineria punon me ndërresa, kontrolli i gjendjes teknike të makinerisë bëhet në praninë e dorëzuesit dhe marrësit në dorëzim. Marrësi në dorëzim, në qoftë se bindet se makineria është në gjendje të mirë, fillon punën, në të kundërtën lajmëron menjëherë përgjegjësën për gjendjen teknike të saj. Shënimet mbi gjendjen teknike të makinerisë bëhen në librin e dorëzimit të turnit, me të cilin pajiset çdo makineri që punon me ndërresa.

Neni 26

Personeli inxhiniero-teknik, si dhe manovratorët e makinerive në shoqëritë ndërtimore, janë të detyruar që para vënies në shfrytëzim të makinerive dhe të pajisjeve të njohin dhe të zbatojnë rregullat e përdorimit, mirëmbajtjes dhe sigurimit teknik të tyre, si dhe të kryejnë provat e plota teknike dhe teknologjike.

Neni 27

Subjektet ndërtimore organizojnë punën me makineri në objektet që ndërtojnë sipas një planorganizimi të hartuar e të miratuar prej tyre duke pasur parasysh: kapacitetet teknike, zonat e lëvizjes dhe të manovrimit, thellësitë e gërmimit, këndet e skarpateve, rrugët e kalimit, distancat nga objektet e ndërtuara, shenjat kufizuese për njerëzit etj.

Neni 28

Përdoruesit e makinerive të ndërtimit mbajnë përgjegjësi për gjendjen teknike të makinerisë që përdorin dhe duhet të sigurojnë punë me regjim teknik normal, pa avari dhe me siguri të plotë për jetën e tyre dhe të personave të tjerë që punojnë rreth tyre. Ata nuk zbatojnë asnjë urdhër apo nuk marrin asnjë iniciativë për të punuar në kundërshtim me rregullat teknike dhe rregullat e sigurimit teknik.

Neni 29

Për shkeljen e rregullave të administrimit dhe të përdorimit të makinerive, kanë përgjegjësi sipas rastit, disiplinore, materiale ose penale personat fajtorë, si dhe personat që kanë urdhëruar të punohet në kundërshtim me rregullat teknike dhe rregullat e sigurimit teknik.



Neni 30

Në rast se makineria, si rezultat i përdorimit të saj jo të rregullt, shkakton avari që shoqërohen dhe me viktima, njoftohet menjëherë organi i prokurorisë dhe merren masa për të ruajtur vendin ku ka ndodhur avaria për të mos bërë ndryshime. Përfshihen rastet kur duhen nxjerrë personat e dëmtuar nga avaria për t'u dhënë ndihmën mjekësore, si dhe për të likuiduar vatrën që mund të zmadhojë dëmin.

Neni 31

Përdorimi i makinerive të rënda të ndërtimit pa dëshminë e aftësisë profesionale përbën dhe ndëshkohet si shkelje e rregullave të sigurimit teknik.

Neni 32

Dispozita të përgjithshme

1. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor të marrë të gjitha masat e duhura për zbatimin e kësaj rregulloreje brenda 15 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor të marrë masa për përgatitjen e autorizimit të identifikimit të kandidatit, protokollit të rezultateve të kandidatit në kurset e trajnimit teoriko-praktik, protokollit të rezultateve të provimit me shkrim, si dhe regjistri i dëshmive të lëshuara dhe të tërhequra.

3. Bashkëlidhur janë programi teoriko-praktik, autorizimi për regjistrimin e aplikantit dhe modelet e dëshmive të aftësisë.

SHTOJCA NR. 1

Programi teorik-praktik për zhvillimin e kursit, që ndiqet nga subjektet juridike, do të organizohet si më poshtë:

Kursi teorik përfshin njohuri për:

Makineritë e ndërtimit

Motorët me djegie të brendshme

Sistemet e frenimit

Sistemet e lëvizjes dhe të drejtimit

Sistemet hidraulike

Sistemet elektrike dhe elektronike në komandim

Sistemet e ngritjes (polispaset, kavot, cilindrat, pultet e komandimit, pompat hidraulike, shpërndarësit etj.)

Gjithsej 16 orë kursi teorik

Materiali bazë studimor:

- Ligj nr. 8378, datë 22.7.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

- VKM nr. 153, datë 7.4.2000, Rregullore në zbatim të Kodit Rrugor të RSH-së.

- VKM nr. 8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar.

Kursi praktik përfshin njohuri për:

Funksionimin e sistemeve të lëvizjes dhe të frenimit

Funksionimin e sistemeve hidraulike dhe të ngritjes

Manovrat me makineritë e rënda të ndërtimit dhe punimit të tokës

Defektet e mundshme teknike dhe shërbimet përkatëse gjatë punës

Shërbimet periodike (ndërrim vaj motori, vaji hidraulik, filtra etj.)

Rregullat e sigurimit teknik

Gjithsej 8 orë kursi praktik

Model DKP-41



REPUBLIKA E SHQIPERISE
Ministria e Punëve Publike dhe Transportit
Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor
Drejtoria Rajonale _____

Nr. _____

Datë ____/____/____

AUTORIZIM

Për përgatitjen teorike dhe praktike të aplikantit për tu pajisur me Dëshmi të Aftësisë Profesionale (DAP) të llojit;

AUTOMEKANIST

Pjesa A. Identifikimi

Aplikanti:

Emri _____ Atësia _____ Amësia _____ Mbiemri _____

Datëlindja _____ Vendlindja _____ Vendbanimi _____

Adresa _____


Nr. Identifikimit _____

Kategoria e lejes së drejtimit që ka, _____

Nr. Lejes së Drejtimit, _____, Data e lëshimit, _____

Autorizohet të aftësohet për përdorimin e makinerive të rënda për punime
Ndërtimi dhe toke të llojit **Buldozer**

Autorizimi është i vlefshëm deri më datë, _____



Foto

(Emër mbiemër firmë)

Drejtori Rajonal

(emri, mbiemri, firma, vula)

Pjesa B. Subjekti që kryen trajnimin

Subjekti Juridik ku do të kruhet trajnimi _____ Nr. NIPTI _____

Nr. Liçensës _____, lëshuar në datën _____.

APLIKNTI u regjistrua në datë _____ me numur amze _____

Filloi trajnimin teorik në datë _____ dhe e përfundoi në datë _____

Filloi trajnimin praktik në datë _____ dhe e përfundoi në datë _____

Titullari i Subjektit Juridik

(Emri, mbiemri, firma)

Drejtuesi i Teknik

(Emri, mbiemri)



Pjesa C. Deklarata

Unë _____, deklaroj me vullnetin tim të lirë se kam kryer të gjithë kursin teorik dhe praktik pranë këtij subjekti dhe e shohë veten të aftë për përdorimin e çdo makinerie me bazë automjetin dhe prandaj kërkoj nga Komisioni i posaçëm i DPSHTRr-së të më marrë në testimin teorik

APLIKANTI

(_____)
Emër, mbiemër, firmë

Pjesa D. Vlerësimi nga komisioni i provimit teorik.

Nr. provim	Nr.prot	Data e provimit	Nr. testit	Nr.pikëve	Rezultati	KOMISIONI		
						Kryetar	Anetar	Anetar
1								
2								
3								
4								
5								

Model DKP-41



REPUBLIKA E SHQIPERISE
Ministria e Punëve Publike dhe Transportit
Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor
Drejtoria Rajonale _____

Nr. _____

Datë ____/____/____

AUTORIZIM

Për përgatitjen teorike dhe praktike të aplikantit për tu pajisur me Dëshmi të Aftësisë Profesionale (DAP) të llojit;

BULDOZERIST ME GOMA

Pjesa A. Identifikimi

Aplikanti:

Emri _____ Atësia _____ Amësia _____ Mbiemri _____

Datëlindja _____ Vendlindja _____ Vendbanimi _____

Adresa _____

Nr. Identifikimit _____

Kategoria e lejes së drejtimit që ka, _____

Nr. Lejes së Drejtimit, _____, Data e lëshimit, _____

Autorizohet të aftësohet për përdorimin e makinerive të rënda për punime Ndërtimi dhe toke të llojit **Buldozer**



Foto

(Emer mbiemer firme)

Autorizimi është i vlefshëm deri më datë, _____

Drejtori Rajonal

(_____)

(emri, mbiemri, firma, vula)

Pjesa B. Subjekti që kryen trajnimin

Subjekti Juridik ku do të kruhet trajnimi _____ Nr. NIPTI _____

Nr. Liçensës _____, lëshuar në datën _____.

APLIKNTI u regjistrua në datë _____ me numur amze _____

Filloi trajnimin teorik në datë _____ dhe e përfundoi në datë _____

Filloi trajnimin praktik në datë _____ dhe e përfundoi në datë _____

Titullari i Subjektit Juridik

(_____)

Emri, mbiemri, firma

Drejtuesi i Teknik

(_____)

Emri, mbiemri



Pjesa C. Deklarata

Unë _____, deklarojë me vullnetin tim të lirë se kam kryer të gjithë kursin teorik dhe praktik pranë këtij subjekti dhe e shohë veten të aftë për përdorimin e çdo makinerie të llojit **Buldozer** me **goma** dhe **zinxhirë** dhe prandaj kërkoj nga Komisioni i posaçëm i DPSHTRr-së të më marrë në testimin teorik

APLIKANTI

(_____)
Emër, mbiemër, firmë

Pjesa D. Vlerësimi nga komisioni i provimit teorik.

Nr. provim	Nr. prot	Data e provimit	Nr. testit	Nr. pikëve	Rezultati	KOMISIONI		
						Kryetar	Anetar	Anetar
1								
2								
3								
4								
5								

Model DKP-41



REPUBLIKA E SHQIPERISE
Ministria e Punëve Publike dhe Transportit
Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor
Drejtoria Rajonale _____

Nr. _____

Datë ____/____/____

AUTORIZIM

Për përgatitjen teorike dhe praktike të aplikantit për tu pajisur me Dëshmi të Aftësisë Profesionale (DAP) të llojit;

BULDOZERIST ME ZINXHIRE

Pjesa A. Identifikimi

Aplikanti:

Emri _____ Atësia _____ Amësia _____ Mbiemri _____

Datëlindja _____ Vendlindja _____ Vendbanimi _____

Adresa _____

Nr. Identifikimit _____

Kategoria e lejes së drejtimit që ka, _____

Nr. Lejes së Drejtimit, _____, Data e lëshimit, _____

Autorizohet të aftësohet për përdorimin e makinerive të rënda për punime

Ndërtimi dhe toke të llojit **Buldozer**

Foto

(Emer mblemer firme)

Drejtori Rajonal

(emri, mbiemri, firma, vula)

Pjesa B. Subjekti që kryen trajnimin

Subjekti Juridik ku do të kruhet trajnimi _____ Nr. NIPTI _____

Nr. Liçensës _____, lëshuar në datën _____.

APLIKNTI u regjistrua në datë _____ me numur amze _____

Filloi trajnimin teorik në datë _____ dhe e përfundoi në datë _____

Filloi trajnimin praktik në datë _____ dhe e përfundoi në datë _____

Titullari i Subjektit Juridik

(Emri, mbiemri, firma)

Drejtuesi i Teknik

(Emri, mbiemri)



Pjesa C. Deklarata

Unë _____, deklarojë me vullnetin tim të lirë se kam kryer të gjithë kursin teorik dhe praktik pranë këtij subjekti dhe e shohë veten të aftë për përdorimin e çdo makinerie të llojit **Buldozer** me zinxhirë dhe prandaj kërkoj nga Komisioni i posaçëm i DPSHTRr-së të më marrë në testimin teorik

APLIKANTI

(_____)
Emër, mbiemër, firmë

Pjesa D. Vlerësimi nga komisioni i provimit teorik.

Nr. provim	Nr.prot	Data e provimit	Nr. testit	Nr.pikëve	Rezultati	KOMISIONI		
						Kryetar	Anetar	Anetar
1								
2								
3								
4								
5								

Model DKP-41



REPUBLIKA E SHQIPERISE
Ministria e Punëve Publike dhe Transportit
Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor
Drejtoria Rajonale _____

Nr. _____

Datë ____/____/____

AUTORIZIM

Për përgatitjen teorike dhe praktike të aplikantit për tu pajisur me Dëshmi të Aftësisë Profesionale (DAP) të llojit;

EKSKAVATORIST ME GOMA

Pjesa A. Identifikimi

Aplikanti:

Emri _____ Atësia _____ Amësia _____ Mbiemri _____

Datëlindja _____ Vendlindja _____ Vendbanimi _____


Adresa _____

Nr. Identifikimit _____

Kategoria e lejes së drejtimit që ka, _____

Nr. Lejes së Drejtimit, _____, Data e lëshimit, _____

Autorizohet të aftësohet për përdorimin e makinerive të rënda për punime Ndërtimi dhe toke të llojit **Buldozer**



Foto

(Emër mbilemer firme)

Autorizimi është i vlefshëm deri më datë, _____

Drejtori Rajonal

(_____)

(Emri, mbiemri, firma, vula)

Pjesa B. Subjekti që kryen trajnimin

Subjekti Juridik ku do të kruhet trajnimi _____ Nr. NIPTI _____

Nr. Liçensës _____, lëshuar në datën _____.

APLIKNTI u regjistrua në datë _____ me numur amze _____

Filloi trajnimin teorik në datë _____ dhe e përfundoi në datë _____

Filloi trajnimin praktik në datë _____ dhe e përfundoi në datë _____

Titullari i Subjektit Juridik

(_____)

Emri, mbiemri, firma

Drejtuesi i Teknik

(_____)

Emri, mbiemri



Pjesa C. Deklarata

Unë _____, deklaroj me vullnetin tim të lirë se kam kryer të gjithë kursin teorik dhe praktik pranë këtij subjekti dhe e shohë veten të aftë për përdorimin e çdo makinerie të llojit **Ekskavator me goma** dhe zinxhirë dhe prandaj kërkoj nga Komisioni i posaçëm i DPSHTRr-së të më marrë në testimin teorik

APLIKANTI

(_____)
Emër, mbiemër, firmë

Pjesa D. Vlerësimi nga komisioni i provimit teorik.

Nr. provim	Nr. prot	Data e provimit	Nr. testit	Nr. pikëve	Rezultati	KOMISIONI		
						Kryetar	Anetar	Anetar
1								
2								
3								
4								
5								

Model DKP-41



REPUBLIKA E SHQIPERISE
Ministria e Punëve Publike dhe Transportit
Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor
Drejtoria Rajonale _____

Nr. _____

Datë ____/____/____

AUTORIZIM

Për përgatitjen teorike dhe praktike të aplikantit për tu pajisur me Dëshmi të Aftësisë Profesionale (DAP) të llojit;

EKSKAVATORIST ME ZINXHIRE

Pjesa A. Identifikimi

Aplikanti:

Emri _____ Atësia _____ Amësia _____ Mbiemri _____

Datëlindja _____ Vendlindja _____ Vendbanimi _____

Adresa _____

Nr. Identifikimit _____

Kategoria e lejes së drejtimit që ka, _____

Nr. Lejes së Drejtimit, _____, Data e lëshimit, _____

Autorizohet të aftësohet për përdorimin e makinerive të rënda për punime

Ndërtimi dhe toke të llojit **Buldozer**

Foto

(Emër mbiemër firme)

Drejtori Rajonal

(emri, mbiemri, firma, vula)

Autorizimi është i vlefshëm deri më datë, _____

Pjesa B. Subjekti që kryen trajnimin

Subjekti Juridik ku do të kruhet trajnimi _____ Nr. NIPTI _____

Nr. Liçensës _____, lëshuar në datën _____.

APLIKANTI u regjistrua në datë _____ me numur amze _____

Filloi trajnimin teorik në datë _____ dhe e përfundoi në datë _____

Filloi trajnimin praktik në datë _____ dhe e përfundoi në datë _____

Titullari i Subjektit Juridik

Emri, mbiemri, firma

Drejtuesi i Teknik

Emri, mbiemri



Pjesa C. Deklarata

Unë _____, deklaroj me vullnetin tim të lirë se kam kryer të gjithë kursin teorik dhe praktik pranë këtij subjekti dhe e shohë veten të aftë për përdorimin e çdo makinerie të llojit **Ekskavatore me zinxhirë** dhe prandaj kërkoj nga Komisioni i posaçëm i DPSHTRr-së të më marrë në testimin teorik

APLIKANTI

(_____)
Emër, mbiemër, firmë

Pjesa D. Vlerësimi nga komisioni i provimit teorik.

Nr. provim	Nr.prot	Data e provimit	Nr. testit	Nr.pikëve	Rezultati	KOMISIONI		
						Kryetar	Anetar	Anetar
1								
2								
3								
4								
5								

Shënim:

- Dëshmia është e vlefshme 5 vjet nga data e lëshimit.
- Çdo korigjim e bën atë të pavlefshme
- Ky dokument pezullohet nga organi që e lëshon.
- Kjo dëshmi është e vlefshme për mjetet e mëposhtme:

1 - makineri ndërtimi me bazë automjeti :

- autovinça
- autobetonierë
- autopompa betoni
- autobitumatriçe
- autosonda
- automakineri shpimi
- automakineri asfaltuese
- automakineri betonshtuese
- moto pirun



Seria Nr. _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE TË
TRANSPORTIT RRUGOR



Dëshmi e Aftësisë Profesionale
Për

Përdoruesit e makinerive të rënda
të ndërtimit dhe punimeve në tokë

Nr. _____

Seria Nr. _____

1. Emri: _____

2. Mbiemri: _____

3. Atësia: _____

4. Datëlindja: _____

Foto
3.5 x 4.2

5. Vendbanimi: _____

6. Lëshohet në bazë të vendimit të
komisionit të testimit

Nr. _____ Dt. ____/____/____

Për: **AUTOMAKINISTË**

7. Lëshohet nga DPSHTRR

8. Data e lëshimit ____/____/____

9. E vlefshme deri më ____/____/____

Drejtori i Përgjithshëm



Shënim:

- Dëshmia është e vlefshme 5 vjet nga data e lëshimit.
- Çdo korigjim e bën atë të pavlefshme
- Ky dokument pezullohet nga organi që e lëshon.
- Kjo dëshmi është e vlefshme për mjetet e mëposhtme:

1 - makineri gërmimi, transporti, nivelimi e ngjeshje dherash:

- buldozerë
- traktorë
- mula-vibrues
- skrepera
- greidera
- shtruese asfalto-betoni
- sonda shpimi me zinxhirë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE TË
TRANSPORTIT RRUGOR



Dëshmi e Aftësisë Profesionale

Për

Përdoruesit e makinerive të rënda
të ndërtimit dhe punimeve në tokë

Nr. _____

1. Emri: _____

2. Mbiemri: _____

3. Atësia: _____

4. Datëlindja: _____



5. Vendbanimi: _____

6. Lëshohet në bazë të vendimit të
komisionit të testimit

Nr. _____ Dt. ____/____/____

Për: **BULDOZERISTË**
me zinxhirë

7. Lëshohet nga DPSHTRR

8. Data e lëshimit ____/____/____

9. E vlefshme deri më ____/____/____

Drejtori i Përgjithshëm

Shënim:

- Dëshmia është e vlefshme 5 vjet nga data e lëshimit.
- Çdo korigjim e bën atë të pavlefshme
- Ky dokument pezullohet nga organi që e lëshon.
- Kjo dëshmi është e vlefshme për mjetet e mëposhtme:

1 - makineri gërmimi, transporti, nivelimi e ngjeshje dherash:

- buldozerë
- traktorë
- muller-vibrues
- skrepera
- greidera
- shtruese asfalto-betoni



Seria Nr. _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE TË
TRANSPORTIT RRUGOR



Dëshmi e Aftësisë Profesionale

Për

Përdoruesit e makinerive të rënda
të ndërtimit dhe punimeve në tokë

Nr. _____

Seria Nr. _____

1. Emri: _____

2. Mbiemri: _____

3. Atësia: _____

4. Datëlindja: _____



Foto
3.5 x 4.2

5. Vendbanimi: _____

6. Lëshohet në bazë të vendimit të
komisionit të testimit

Nr. _____ Dt. ____/____/____

Për **BULDOZERISTË**

7. Lëshohet nga DPSHTRR

8. Data e lëshimit ____/____/____

9. E vlefshme deri më ____/____/____

Drejtori i Përgjithshëm



Shënim:

- Dëshmia është e vlefshme 5 vjet nga data e lëshimit.
- Çdo korigjim e bën atë të pavlefshme
- Ky dokument pezullohet nga organi që e lëshon.
- Kjo dëshmi është e vlefshme për mjetet e mëposhtme:

1 - makineri gërmimi dhe gërmim dherash :

- vetshkarkues
- ngarkues-transportues
- fadroma
- ekskavatorë
- ekskavatorë për hapje kanalesh
- ekskavatorë të kombinuar (me goma dhe me zinxhirë)
- makineri gërmuese drage
- lopata ngarkuese
- autoskreper



Seria Nr. _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE TË
TRANSPORTIT RRUGOR



Dëshmi e Aftësisë Profesionale
Për

Përdoruesit e makinerive të rënda
të ndërtimit dhe punimeve në tokë

Nr. _____

Seria Nr. _____

1. Emri: _____

2. Mbiemri: _____

3. Atësia: _____

4. Datëlindja: _____




Foto
3.5 x 4.2

5. Vendbanimi: _____

6. Lëshohet në bazë të vendimit të
komisionit të testimit

Nr. _____ Dt. ____/____/____

Për : **EKSKAVATORISTË**
me zinxhirë

7. Lëshohet nga DPSHTRR

8. Data e lëshimit ____/____/____

9. E vlefshme deri më ____/____/____

Drejtori i Përgjithshëm

Shënim:

- Dëshmia është e vlefshme 5 vjet nga data e lëshimit.
- Çdo korigjim e bën atë të pavlefshme
- Ky dokument pezullohet nga organi që e lëshon.
- Kjo dëshmi është e vlefshme për mjetet e mëposhtme:

1 - makineri gërmimi dhe gërmim dherash :

- vetshkarkues
- ngarkues-transportues
- fadroma
- ekskavatorë
- ekskavatorë për hapje kanalesh
- ekskavatorë të kombinuar (me goma dhe me zinxhirë)
- makineri gërmuese drage
- lopata ngarkuese
- autoskreper



Seria Nr. _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE TË
TRANSPORTIT RRUGOR



Dëshmi e Aftësisë Profesionale

Për

Përdoruesit e makinerive të rënda
të ndërtimit dhe punimeve në tokë

Nr. _____

Seria Nr. _____

1. Emri: _____

2. Mbiemri: _____

3. Atësia: _____

4. Datëlindja: _____




Foto
3.5 x 4.2

5. Vendbanimi: _____

6. Lëshohet në bazë të vendimit të
komisionit të testimit

Nr. _____ Dt. ____/____/____

Për : **EKSKAVATORISTË**

7. Lëshohet nga DPSHTRR

8. Data e lëshimit ____/____/____

9. E vlefshme deri më ____/____/____

Drejtori i Përgjithshëm

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Hyri në shtyp më 20.8.2013
Doli nga shtypi më 20.8.2013

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2013

Çmimi 54 lekë